



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 66 regjistër (JR)

Datë 09.11.2021

Nr. 65 i vendimit

Datë 17.12.2024

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

Ina Rama	Kryesuese
Sokol Çomo	Relator
Natasha Mulaj	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare
Albana Shtylla	Anëtare

- mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 17.12.2024, ditën e martë, ora 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Steven Kessler, me Sekretare Gjyqësore Ina Xhetani, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 66/2021 (JR), datë 09.11.2021, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Desart Avdulaj, gjyqtar në Gjykatën e Apelit Durrës.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 391, datë 26.05.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Desart Avdulaj.

BAZA LIGJORE: Neni F i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet 42 dhe 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 1, 2, 62, 63 dhe 66, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; neni 46 e vijues i ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar; Kodi i Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, shqyrtoi shkaqet e ankimit dhe pretendimet në parashtrimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit, dëgjoi gjyqtarin relator të çështjes Sokol Çomo, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Desart Avdulaj (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), për shkak të ushtrimit të funksionit të gjyqtarit në Gjykatën e Apelit Durrës, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar, *ex officio*, në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016.
2. Në përputhje me nenet 31, pika 1, 35, pika 1 dhe 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar brenda afatit ligjor, në organet ndihmëse përkatëse, deklaratën e pasurisë¹ për procesin e rivlerësimit (në vijim “deklarata *vetting*”), në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), deklaratën për kontrollin e figurës pranë Drejtorisë së Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar, si dhe formularin për vetëvlerësimin profesional.
3. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), bazuar në përcaktimet e neneve 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, ka administruar² raportet e hartuara nga ILDKPKI-ja, DSIK-ja dhe Këshilli i Lartë i Gjyqësor (në vijim “KLGj”).
4. Inspektori i Përgjithshëm i ILDKPKI-së, pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, ka konstatuar se: (i) deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin dhe ka mosdeklarim pasurie; (ii) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; (iii) nuk ka kryer fshehje të pasurisë; (iv) nuk ka kryer deklarim të rremë; (v) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.
5. Bazuar në nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara për subjektin e rivlerësimit nga ILDKPKI-ja, DSIK-ja dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor, kreu procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Desart Avdulaj, bazuar vetëm në kriterin e vlerësimit të pasurisë, duke marrë në përfundim të procesit vendimin nr. 391, datë 26.05.2021.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

¹ Dorëzuar pranë ILDKPKI-së më datë 28.01.2017, sipas vërtetimit të ILDKPKI-së me nr. {***} prot., datë 28.01.2018.

² Pika 3 e vendimit të Komisionit.

6. Komisioni, me vendimin nr. 391, datë 26.05.2021, vendosi: “Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Desart Avdulaj, gjyqtar në Gjykatën e Apelit Durrës”.
7. Ky vendim është marrë mbështetur në nenin 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, bazuar në konkluzionet e mëposhtme.

- Subjekti i rivlerësimit ka pasaktësi në deklaratën e pasurisë “vetting” lidhur me burimin e krijimit të pasurive dhe mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë, në kuptim të parashikimeve të nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 33, pika 5, gjerat “a”, “b” dhe “c”, dhe në kuptim të parashikimeve të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

- Në kuptim të parashikimeve të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te drejtësia pasi veprimet e subjektit të rivlerësimit, referuar sa analizuar në pikat 2, 4 dhe 7 të këtij vendimi, përbëjnë zgjedhje të cilat nuk shërbejnë në krijimin e besimit të publikut te drejtësia.

III. Ankimi i subjektit të rivlerësimit

8. Subjekti i rivlerësimit i është drejtuar Kolegjit me ankim kundër vendimit të Komisionit nr. 391, datë 26.05.2021, duke kërkuar: *Prishjen e vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 391, datë 26.05.2021 dhe urdhërimin e vazhdimin të kryerjes së procesit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Desart Avdulaj edhe për kriteret e kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale. Prishjen e vendimit të sipërcituar pasi janë cenuar rregullat procedurale për formimin e rregullt të trupit, si element i rëndësishëm i parimit kushtetues i gjykatës së krijuar me ligj. Prishjen e vendimit të ndërmjetëm të datës 19.05.2021 për refuzimin e kërkesës për riçeljen e hetimit administrativ dhe vazhdimin e hetimit edhe për dy kriteret e tjera.*
9. Më datë 12.12.2024, subjekti i rivlerësimit depozitoi në Kolegj parashtime me shkrim lidhur me shkaqet e ngritura në ankim, në përputhje me parashikimet e nenit 49, paragrafi i dytë i ligjit nr. 49/2012.

IV. Gjykimi i ankimit në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit

A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

10. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji, si e vetmja gjykatë e procesit të rivlerësimit, ka juridiksion (*ratione materiae*) për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin kalimtar të subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për rivlerësimin

e subjektit Desart Avdulaj, duke e shkarkuar atë nga detyra, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) *Legjitimimi i ankuesit*

11. Ankuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh³ nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

c) *Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit*

12. Në përputhje me nenin 65⁴, pika 12 e ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i çështjes në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull, kryhet në dhomë këshillimi mbi bazë aktesh, përveç rasteve kur trupi gjykues në vijim vendos se plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012”), për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike me praninë e palëve. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e vendimit nr. 391, datë 26.05.2021, të Komisionit, bazuar në shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit Desart Avdulaj, u mor fillimisht në shqyrtim nga Kolegji në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi.
13. Trupi gjykues shqyrtoi fillimisht kërkesën e subjektit të rivlerësimit, për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e subjektit të rivlerësimit dhe marrjen e disa provave të reja. Subjekti i rivlerësimit, së bashku me ankimin, ka depozituar shkresën me nr. {***} prot., datë 02.08.2021, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Shkodër dhe aktet bashkëlidhur saj. Trupi gjykues vendosi të refuzojë kërkesën e subjektit të rivlerësimit për marrjen e provave të reja, pasi nga analiza e kryer në kuadër të parashikimeve të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, sipas të cilit: *Në ankim nuk mund të paraqiten fakte të reja dhe të kërkohen prova të reja, përveçse kur ankuesi provon se pa fajin e tij, nuk ka mundur t'i paraqesë këto fakte ose t'i kërkojë këto prova në shqyrtimin e çështjes në gjykatën administrative të shkallës së parë, në afatet e parashikuara në këtë ligj*, si dhe nenit 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016, ku parashikohet: *Kërkesa për marrjen e një prove refuzohet nga Komisioni ose Kolegji i Apelit, nëse nuk lejohet nga ligji ose në rastet kur: a) marrja e provës duket se është e panevojshme; b) fakti që kërkohet të provohet, është i parëndësishëm për vendimmarrjen ose mund të rezultojë i provuar gjatë gjykimit; [...] d) pretendohet të provohet një fakt në favor të subjektit të rivlerësimit, i cili edhe po të konsiderohet i vërtetë, nuk ndikon në marrjen e vendimit*, u arrit në përfundimin se nuk plotësohen kërkesat e dispozitave procedurale të sipërcituara për

³ Siç rezultoi nga aktet e administruara në fashikullin gjyqësor, vendimi i Komisionit nr. 391, datë 26.05.2024, i është njoftuar subjektit të rivlerësimit më datë 08.10.2021, dhe ankimi i subjektit rezulton të jetë depozituar pranë shërbimit postar më datë 25.10.2021, që rezulton të jetë dita 14 nga data e marrjes dijeni për vendimin e Komisionit.

⁴ Procesi gjyqësor në Kolegjin e Apelit kryhet në përputhje me rregullat e parashikuara në nenet 47, 48, pika 1, 49, 51 dhe 55 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

pranueshmërinë e këtyre akteve në cilësinë e provave të reja në proces. Subjekti i rivlerësimit nuk provoi pamundësinë e paraqitjes së tyre gjatë procesit në Komision, por njëkohësisht nuk u konsideruan të nevojshme për shkak se lidheshin me pretendime të pangritura në ndonjë fazë të procesit të rivlerësimit në Komision. Ato nuk lidheshin me veprime apo mosveprime konkrete procedurale të Komisionit në procesin e rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit.

14. Trupi gjykues, pasi kontrolloi zhvillimin e procesit të rivlerësimit në Komision, nuk konstatoi shkelje procedurale të tilla që kërkojnë korrigjimin e tyre sipas parashikimeve të nenit 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012, duke kaluar gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike në prani të subjektit të rivlerësimit. Për rrjedhojë, në përfundim edhe të analizës së kryer lidhur me kërkesën e subjektit për marrjen e provave të reja, në kuadër të kërkit të tij në ankim për shqyrtimin e çështjes në seancë publike, trupi gjykues vendosi ta shqyrtojë çështjen në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, mbi bazën e dokumenteve të administruara në fashikullin e Komisionit, sipas parashikimeve të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012.

B. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit që lidhen me aspekte procedurale të procesit të rivlerësimit të kryer nga Komisioni

15. Subjekti i rivlerësimit nëpërmjet ankimit i kërkoi Kolegjit konstatimin e shkeljes nga Komisioni në procesin e tij të rivlerësimit kalimtar të të drejtave kushtetuese dhe ligjore, si dhe atyre të parashikuara nga Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në vijim “KEDNj”).
16. Shkaqet e ankimit lidhur me aspektet procedurale janë bazuar në pretendimet si më poshtë.
 - Vendimi nr. 391, datë 26.05.2021, i Komisionit është marrë mbi bazën e një hetimi dhe vlerësimi administrativ të paplotë, në shkelje të parimeve themelore procedurale, pasi ndaj tij është zhvilluar një proces i parregullt ligjor në kuptim të nenit 42 e 179/b, pika 2 e Kushtetutës, nenit 6 të KEDNj-së, si dhe nenit 4, pikat 5 dhe 6, nenit 52, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.
 - Komisioni ka cenuar të drejtën e subjektit të rivlerësimit për proces të rregullt ligjor në kuptim të nenit 6 të KEDNj-së, si pasojë e faktit se subjekti nuk është gjykuar nga një gjykatë e pavarur, e paanshme dhe e krijuar me ligj⁵.
 - Komisioni ka tejkaluar kufizimet e përcaktuara në ligj në ushtrimin e diskrecionit, në kundërshtim me parimin e sigurisë juridike.
 - Vendimi i Komisionit është i cenueshëm për shkak të mosformimit të rregullt të trupit gjykues⁶.
17. Subjekti i rivlerësimit pretendon për shkelje të nenit 6 të KEDNj-së, pasi, sipas tij, bazuar në analizën e kritereve të përcaktuara nga GjEDNj-ja në çështjen Volkov kundër Ukrainës, trupi gjykues i Komisionit që ka shqyrtuar çështjen e tij, nuk ka qenë i pavarur dhe i paanshëm në drejtim të: (i) përfaqësimit thelbësor të komunitetit të gjyqtarëve dhe prokurorëve në përbërjen e tij, pasi të

⁵ Referuar jurisprudencës së GjEDNj-së në çështjen Volkov kundër Ukrainës dhe Denisov kundër Ukrainës.

⁶ I referohet vendimit të Kolegjit nr. 11, datë 31.03.2021.

tre komisionerët kanë qenë gjyqtarë; (ii) procedurës së caktimit të anëtarëve të Komisionit e cila ka qenë me defekte pasi të tre komisionerët nuk plotësonin kushtet e zgjedhjes të parashikuara në nenin 6 të ligjit nr. 84/2016; (iii) mbivendosjes së funksioneve hetimore me ato gjyqësore, pasi hetimi administrativ dhe dhënia e vendimit për subjektin e rivlerësimit është bërë nga i njëjti trup gjykues; (iv) kohëzgjatjes së mandatit të anëtarëve të Komisionit, statusit të tyre, si dhe faktit që të tre komisionerët janë zgjedhur nga një organ politik (Kuvendi).

18. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkakut ankimi, trupi gjykues vlerëson se Kolegji ka një qëndrim të konsoliduar në jurisprudencën e tij, lidhur me analizën dhe vlerësimin e pretendimeve të subjektit të rivlerësimit. Kuadri ligjor i procesit të rivlerësimit kalimtar ka kaluar testin e kontrollit kushtetues nga Gjykata Kushtetuese⁷ edhe të kontrollit të GjEDNj-së⁸. Në qëndrimin e saj, Gjykata Kushtetuese ka vlerësuar se dispozitat ligjore mbi të cilat mbështetet krijimi dhe funksionimi i institucioneve të rivlerësimit, janë në përputhje me Kushtetutën dhe ofrojnë garanci të plota të procesit të rregullt gjyqësor, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6 të KEDNj-së.
19. Lidhur me pretendimin se anëtarët e trupit gjykues të Komisionit që shqyrtuan çështjen e tij, nuk plotësojnë kriteret e përcaktuara në nenin 6 të ligjit nr. 84/2016 për t'u zgjedhur komisionerë⁹, trupi gjykues konfirmon qëndrimin e mbajtur në çështje të tjera nga Kolegji¹⁰, në përputhje edhe me vlerësimin e GjEDNj-së¹¹, sipas të cilit: *[...] trupi gjykues i Kolegjit çmon të theksojë natyrën e jashtëzakonshme të procesit të rivlerësimit dhe qëllimin e legjislatorit që, në kontekstin e një vlerësimi kalimtar, përzgjedhja e anëtarëve të institucioneve të rivlerësimit t'u nënshtrohej disa procedurave të mirëpërcaktuara. Mbi bazën e këtyre parimeve, edhe përzgjedhja e anëtarëve të institucioneve pasqyroi vullnetin politik të përfaqësuar të shoqërisë shqiptare. Në zbatim të këtij qëllimi, ligji nr. 84/2016, mbi bazën e të cilit është kryer përzgjedhja e anëtarëve të institucioneve, përcakton në detaj dhe çdo hap që do të duhet t'i paraprinte emërimin fundor të tyre. Me fjalë të tjera, qëllimi i legjislatorit, për të krijuar një infrastrukturë të aftë për të kryer procesin, është shoqëruar me garanci që përjashtojnë kontestimin e mandateve të anëtarëve të institucioneve, që nëse do t'i lihej rastësisë do të sfidonte qëllimin dhe natyrën e jashtëzakonshme, kalimtare dhe me afat të përcaktuar të procesit të rivlerësimit. Së fundmi, në këtë analizë të gjithanshme të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues mban në konsideratë balancën që duhet të mbahet në funksion të sigurisë ligjore dhe kohës që ka kaluar nga momenti i krijimit të*

⁷ Shih vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 2/2017 dhe nr. 78/2017, mbështetur në Opinionin nr. CDL-AD(2016) 036 të Komisionit të Venecias: [https://www.venice.coe.int/ëebforms/documents/?pdf=CDL-AD\(2016\)036](https://www.venice.coe.int/ëebforms/documents/?pdf=CDL-AD(2016)036).

⁸ GjEDNj-ja në çështjen Altina Xhoxhaj k. Shqipërisë, paragrafët 295-300.

⁹ Subjekti i rivlerësimit pretendon se komisionerja Xh. P. dhe komisionerja B. B. nuk përmbushin kriterin e përvojës profesionale të parashikuar në shkronjën "b" të pikës 1 të nenit 6 të ligjit, ndërsa kryesuesi i trupës gjyqësore, komisioneri R. I., sipas subjektit të rivlerësimit, nuk përmbush kriterin e shkronjës "d" të pikës 1 të nenit 6 të ligjit nr. 84/2016, duke qenë se në momentin e zgjedhjes, ndaj tij kishte nisur një hetim penal.

¹⁰ Shih vendimet e Kolegjit (JR) nr. 43, datë 15.11.2022, (JR) nr. 3, datë 06.02.2023.

¹¹ Shih vendimet e GjEDNj-së, çështja Altina Xhoxhaj kundër Shqipërisë, paragrafët 66-73; çështja Besnik Cani kundër Shqipërisë, paragrafët 66-73, çështja Antoneta Sevdari kundër Shqipërisë, paragrafi 109; çështja Admir Thanza kundër Shqipërisë, paragrafët 83-84.

institucioneve të rivlerësimit, përfshirë edhe Komisionin. Nën dritën e efektit që do të kishte kontestimi pa afat mbi bazën e pretendimeve për gjykatë të krijuar me ligj, sipas testit të vendosur nga GjEDNj-ja, trupi gjykues i Kolegjit çmon të theksojë peshën me të cilën shoqërohet siguria ligjore me kalimin e kohës kundrejt të drejtave individuale të subjektit të rivlerësimit. Këto të drejta, në rrethanat konkrete, pa përsëritur sa është shtjelluar më sipër, konsiderohen të adresuara nga kontrolli i gjithanshëm i vendimit të Komisionit, kryer në Kolegj [...]. Në vijim të kësaj analize, pretendimet e subjektit lidhur me kuadrin kushtetues dhe ligjor të procesit të rivlerësimit kalimtar, vlerësohen të pabazuara.

20. Subjekti i rivlerësimit ka ngritur si shkak ankimi edhe mosformimin e rregullt të trupit gjykues, si një fakt që e bën vendimmarrjen e Komisionit të cënueshme, duke pretenduar se më datë 12.05.2020, është njoftuar nëpërmjet postës elektronike se për shkak të gjendjes shëndetësore, njëra nga anëtarët e trupit gjykues është zëvendësuar nga një komisionere tjetër. Subjekti pretendon se zëvendësimi i komisioneres me short është bërë tej rasteve të parashikuara në parashikimet ligjore për zëvendësimin e gjyqtarit, vetëm nëpërmjet institutit të “përrjashtimit” dhe “heqjes dorë nga gjykimi”. Subjekti i rivlerësimit pretendon se nga korrespondenca me Komisionin, nuk i është bërë asnjëherë me dije procedura e ndjekur për ndryshimin e trupit gjykues dhe nëse ka akt të “heqjes dorë” apo të “përrjashtimit” të komisioneres së zëvendësuar, relatores A. F.. Subjekti ka kërkuar nga Kolegji që të analizojë të gjithë procedurën ligjore të ndjekur, nga data 15.03.2019 deri më datë 10.04.2020, për formimin e trupit gjykues që ka marrë në shqyrtim çështjen e tij, me pretendimin se ka procedura jo të rregullta me pasojë cenimin e vendimit.
21. Lidhur me këtë shkak ankimi, trupi gjykues, nga aktet e fashikullit të Komisionit, konstaton se me anë të komunikimit të datës 12.05.2020, Komisioni e ka njoftuar subjektin e rivlerësimit nëpërmjet postës elektronike në lidhje me ndryshimin e trupit gjykues nëpërmjet shortit, shkakun e ndryshimit, duke e ftuar atë të shprehet në lidhje me gjendjen e kushteve të konfliktit të interesit me anëtarin zëvendësues¹². Në përgjigje të këtij *e-mail*-i, subjekti i rivlerësimit, më datë 13.05.2020, ka deklaruar se “nuk gjendet në kushtet e konfliktit të interesit” me komisioneren zëvendësuese Xh. P.. Referuar komunikimit të mësipërm, nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë paraqitur ndonjë rezervë në lidhje me këtë zëvendësim dhe as të ketë kërkuar informacion në lidhje me shkakun e zëvendësimit apo ndonjë dokument tjetër në lidhje me procedurën e zëvendësimit. Në përfundim të seancës dëgjimore të datës 21.05.2021¹³, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se e konsideronte të rregullt procesin e rivlerësimit në të cilin i ishin realizuar të drejtat

¹² *E-mail i datës 12.05.2020: “Komisioni i Pavarur i Kualifikimit ju bën me dije se, për arsye shëndetësore, komisionerja A. F. nuk është më anëtare e trupës gjykuese që do të kryejë vlerësimin tuaj. Ajo është zëvendësuar nëpërmjet shortit të datës 10.04.2020 nga komisionerja Xh. P.. Ju ftojme të shpreheni nëse gjendeni në kushtet e ndonjë konflikti interesash me anëtarin zëvendësues të trupit gjykues, për sa kohë, lidhur me dy anëtarët e tjerë, ju jeni shprehur për mospasjen e konfliktit të interesit”.*

¹³ *Referuar faqes 38 të procesverbalit të seancës dëgjimore më datë 21.05.2021, i pyetur nga Komisioni në lidhje me vlerësimin e tij mbi procesin e realizuar në Komision, subjekti ka deklaruar se e konsideron procesin të rregullt.*

dhe ka kërkuar të vlerësohet pozitivisht për kriterin mbi të cilin ishte zhvilluar hetimi administrativ, duke kërkuar të hetohet edhe për dy kriteret e tjera të rivlerësimit.

22. Në kushtet kur subjekti i rivlerësimit nuk ka ngritur përpara Komisionit asnjë pretendim për formimin e trupit gjykues, ekzistencën e ndonjë shkakut konflikti interesi apo të cenimit të pavarësisë apo paanësisë të komisioneres Xh. P., vlerësohet se pretendimi i subjektit të rivlerësimit për mosformim të rregullt të trupit gjykues ka rënë në dekadencë dhe nuk mund të ngrihet në Kolegj. Për sa analizuar më sipër, trupi gjykues e vlerëson të papranueshëm këtë pretendim.

C. *Shkaqet e ankimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe vlerësimi i trupit gjykues*

➤ *Lidhur me pasurinë “apartament banimi”, me sipërfaqe 169,8 m², të ndodhur në Rrugën e {***}, Tiranë:*

23. Subjekti i rivlerësimit kundërshton si të gabuar vlerësimin e Komisionit se *subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë apartament banimi me sipërfaqe 169,8 m², në Rrugën e {***}, Tiranë në shumën 101.880 euro, në kuptim të parashikimeve të nenit D, pikave 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe germës “b” të pikës 5 të nenit 33 dhe pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.*
24. Ky vlerësim i Komisionit është bazuar në konkluzionet se: (i) subjekti nuk ka provuar bindshëm mundësinë financiare të personit tjetër të lidhur, z. J. A. (vëllai), për dhënien hua të shumës 20.000 euro në datën 3.4.2015; (ii) subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë me dokumentacion ligjor mundësinë financiare të personit tjetër të lidhur, z. A. K., për dhënien hua të shumës 20.000 euro në vitin 2015; (iii) subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë burimin e ligjshëm të të ardhurave të personit tjetër të lidhur, z. K. A. (vëllai i subjektit), për dhënien e huasë në shumën 10.000 euro në vitin 2010 dhe për t’i dhënë hua shumën e pretenduar, 10.000 euro, në vitin 2015; (iv) likuiditetet *cash* në banesë, të llogaritura si të mundshme për t’u kursyer, rezultojnë në vlerën 2.641.157 lekë, duke qenë të pamjaftueshme për pagesën e shumës 31.880 euro, të deklaruara (nga kursimet e ruajtura në banesë gjatë viteve), si pjesë e çmimit të paguar për blerjen e pasurisë apartament me sipërfaqe 169,8 m² në Rrugën e {***}, Tiranë.
25. Subjekti i rivlerësimit e ka bazuar këtë shkak ankimi në pretendimet se: (i) në lidhje me huanë e marrë nga vëllai i tij J. A., ka arritur të provojë burimin e ligjshëm të shumës së marrë hua prej 20.000 eurosh dhe mundësinë e personit tjetër të lidhur për dhënien e saj, në kuptim të parashikimeve të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 dhe të qëndrimeve të Kolegjit në jurisprudencën e tij; (ii) në lidhje me huanë e marrë nga z. A. K., ka arritur të provojë burimin e ligjshëm të shumës prej 20.000 eurosh dhe mundësinë e personit tjetër të lidhur për dhënien e saj, në kuptim të parashikimeve të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 dhe të qëndrimeve të Kolegjit në jurisprudencën e tij; (iii) në lidhje me huatë e marrë nga vëllai i tij K. A., ka arritur të provojë burimin e ligjshëm të dy huave dhe mundësinë e personit tjetër të lidhur për dhënien e tyre, në kuptim të parashikimeve të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 dhe të qëndrimeve të Kolegjit në jurisprudencën e tij; (iv) në lidhje me ligjshmërinë e likuiditeteve *cash* në banesë, prej 31.880

eurosh, duhet të përfshihet shuma 500.000 lekë nga dhuratat për bashkëshorten me rastin e martesës dhe shuma 500.000 lekë nga kursimet e bashkëshortes nga paga, të deklaruara gjendje *cash* në DIPP-në e vitit 2009.

26. Lidhur me këtë shkak ankimi, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit, në deklaratën e pasurisë *vetting*, lidhur me këtë pasuri, ka deklaruar: *Blerje apartamenti në Tiranë, Rruga e {***}, sip. 169,8 m², porositur me kontratën e porosisë nr. {***}, datë 08.10.2015, para noteres M. S., Tiranë. Pagaruar e gjithë shuma në këste në datat 23 tetor, 6, 13 dhe 26 nëntor, 4, 21 dhjetor 2015, në Tirana Bank. Blerë me kontratën e shitjes nr. {***}, datë 29.07.2016, para së njëjtës notere. Burimi i krijimit: a) kursime të ruajtura në shtëpi gjatë viteve 31.880 (tridhjetë e një mijë e tetëqind e tetëdhjetë) euro; b) hua të marra nga persona fizikë në shumën 70.000 (shtatëdhjetë mijë) euro. (Apartamenti nuk është akoma gati për banim). Vlera 101.880 (njëqind e një mijë e tetëqind e tetëdhjetë) euro. Pjesa 50%.*
27. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se në analizën financiare të burimeve të krijimit të kësaj pasurie, duhet të përfshihen huatë e marra nga huadhënësit J. A., A. K. dhe K. A., si dhe kursimet e ruajtura në banesë për periudhën 2003-2015, që kanë shërbyer për krijimin e pasurisë objekt shqyrtimi në vitin 2015, trupi gjykues në vijim vlerësoi secilin prej këtyre burimeve.
- *Në lidhje me huanë e marrë nga vëllai J. A.:*
28. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, në rubrikën “Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”: *hua e marrë për blerje apartamenti në shumën 20.000 euro, në datën 21.04.2015, me afat 10-vjeçar, pa interes, ndërsa në rubrikën “Të dhëna konfidenciale” ka deklaruar: hua e marrë për blerje apartamenti nga vëllai J. A., pa interes, me afat 10-vjeçar, në datën 03.04.2015. Burimi: të ardhurat nga paga. Akti noterial nr. {***}, datë 21.04.2015, para noteres H. Sh., Tiranë.*
29. Kjo hua është deklaruar për herë të parë nga subjekti në DIPP-2015, në rubrikën “Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”, ku deklaroi: *hua në shumën 20.000 euro për blerje apartamenti në datën 21.4.2015¹⁴, nga personi fizik J. A., me afat 10-vjeçar, pa interes. Marrëdhënia e huasë është konfirmuar nga huadhënësi me deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 21.04.2015, ku J. A. deklaroi se i ka dhënë hua të vëllait Desart Avdulaj, në datë 03.04.2015, shumën 20.000 euro, pa interes dhe me afat deri më datë 03.04.2025.*
30. Komisioni, pas kontrollit të kësaj huaje, ka arritur në konkluzionin se *subjekti nuk ka provuar bindshëm mundësinë financiare të personit tjetër të lidhur, shtetasit J. A. (vëllai), për dhënien e shumës prej 20.000 eurosh në datën 3.4.2015. Këtë konkluzion, Komisioni e ka mbështetur kryesisht në arsyetimin se situata financiare e huadhënësit në kohën e dhënies së huasë lidhur me detyrime/kredi/overdraftet të pashlyera të tij, si dhe fakti se vetëm dy muaj pas dhënies së huasë subjektit të rivlerësimit, për shlyerjen e dy kredive në lekë, huadhënësi ka përdorur një kredi tjetër*

¹⁴ Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si datë për marrjen e huasë, datën 21.04.2015, e cila duket të jetë data e deklaratës noteriale, ndërkohë në deklaratën noteriale deklarohet se huaja është dhënë në datë 03.04.2015.

(konsumatore me hipotekim) të marrë në datën 12.6.2015 në Raiffeisen Bank në shumën 1.750.000 lekë, gjithashtu, krijuan bindjen e trupit gjykues mbi pamundësinë financiare të huadhënësit për dhënien e kësaj huaje.

31. Subjekti i rivlerësimit i ka kundërshtuar konkluzionet e mësipërme të Komisionit, duke pretenduar se me provat e paraqitura gjatë procesit në Komision, ka arritur të provojë burimin e ligjshëm si dhe mundësinë e vëllait të tij J. A. për dhënien e huasë në shumën 20.000 euro. Sipas subjektit, vëllai i tij ka pasur të ardhura të tatueshme që nga viti 2009 e në vazhdim. Subjekti gjithashtu pretendon se, në kuptim të parashikimeve të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 dhe të qëndrimeve të konsoliduara në jurisprudencën e Kolegjit¹⁵, analizimi i rrethanave të faktit në rastin konkret, duhet të fokusohet në aspektin e ligjshmërisë së burimit të të ardhurave, si dhe mundësisë së personit tjetër të lidhur për dhënien e huasë. Në këtë kuptim, subjekti pretendon se ka arritur të provojë se, për periudhën prill 2013 - prill 2015, vëllai i tij ka pasur të ardhura vetëm nga paga në shumën 5.422.182 lekë, duke i krijuar mundësinë e dhënies së huasë në shumën 20.000 euro ose 2.806.000 lekë, konvertuar në datën e dhënies së huasë. Lidhur me faktin se personi tjetër i lidhur, vëllai J. A., në kohën e dhënies së huasë subjektit të rivlerësimit ka pasur kredi të tijat bankare të pashlyera, si dhe ka marrë një kredi konsumatore apo *overdraft*-e, subjekti i rivlerësimit pretendon se ky fakt nuk përbën ndalim ligjor për dhënien e huasë së përfutur prej tij me qëllim blerjen e apartamentit. Arsyeja e marrjes së kredisë nga personi tjetër i lidhur ka lindur 2 muaj pas dhënies së huasë, si dhe nisur nga vetë lloji i kredisë (konsumatore), nuk mund t'i dihej shkaku i marrjes më parë.
32. Trupi gjykues, pasi shqyrtoi aktet e fashikullit të çështjes dhe analizoi pretendimet e subjektit në raport me provat e marra nga Komisioni dhe arsyetimin e vendimit objekt kontrolli, konstatoi dhe vlerësoi si më poshtë.
33. Gjatë hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit nr. 3 të Komisionit, ka deklaruar se huanë në shumën 20.000 euro, e ka marrë dorazi nga vëllai i tij dhe se destinacioni i përdorimit të kësaj huaje, ka qenë për blerje apartamenti. Për të provuar burimin e të ardhurave për dhënien e huasë nga personi tjetër i lidhur, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur bashkëlidhur deklaratës *vetting* dhe gjatë hetimit administrativ në Komision, dokumentacion ligjor lidhur me të ardhurat nga punësimi pranë Raiffeisen Bank dhe shoqërisë “{***}” ShPK. Rezulton se gjatë periudhës 3.12.2008 - 31.3.2013, huadhënësi J. A. ka përfutur nga punësimi në Raiffeisen Bank, të ardhura neto në shumën 5.053.215 lekë.
34. Nga hetimi administrativ i Komisionit në bazë të informacionit dhënë nga Raiffeisen Bank, ka rezultuar se në datën e dhënies së huasë, personi tjetër i lidhur J. A. ka pasur të pashlyera tri kredi bankare, konkretisht: (i) kredinë e disbursuar më datë 25.08.2011 dhe 26.09.2011, në shumën totale 55.000 euro; (ii) kredinë e disbursuar më datë 3.11.2011 në shumën 200.000 lekë; (iii) kredinë e disbursuar më datë 11.4.2014, në shumën 416.000 lekë dhe vetëm dy muaj pasi i kishte dhënë hua subjektit të rivlerësimit shumën prej 20.000 eurosh, për shlyerjen e dy kredive në lekë ka përdorur

¹⁵ Subjekti i rivlerësimit u referohet vendimeve (JR) nr. 15/2018 dhe (JR) nr. 20/2018 të Kolegjit.

një kredi tjetër (konsumatore), të cilën e ka marrë në datën 12.06.2015 në Raiffeisen Bank, në shumën 1.750.000 lekë.

35. Trupi gjykues, referuar të dhënave nga Raiffeisen Bank¹⁶ në llogarinë bankare në lekë, në emër të z. J. A., konstaton se për periudhën 01.04.2013 - 03.04.2015, konfirmohet pretendimi i subjektit të rivlerësimit se në këtë llogari janë transferuar nga shoqëria “{***}” ShPK, të ardhura nga paga në shumën 5.422.182 lekë, të cilat potencialisht, në pamje të parë, duket se mund të shërbenin për krijimin e shumës së dhënë hua subjektit të rivlerësimit, por bazuar në situatën financiare të personit të lidhur, kur ai ishte debitor për disa kredi bankare me interes tregtar dhe mori një kredi të re rreth dy muaj pasi pretendohet se i kishte dhënë hua shumën 20.000 euro subjektit të rivlerësimit, me një afat shlyerjeje 10-vjeçar dhe pa interes, vlerësohet i drejtë konkluzioni i Komisionit se ai ishte në pamundësi reale financiare për të dhënë këtë hua.

➤ *Në lidhje me huanë e marrë nga personi tjetër i lidhur A. K.:*

36. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, në rubrikën “Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”: *hua e marrë për blerje apartamenti në shumën 20.000 euro në datën 02.07.2015, me afat 10-vjeçar, pa interes, ndërsa në rubrikën “Të dhëna konfidenciale” ka deklaruar: hua e marrë nga shtetasi A. K., pa interes, me afat 10-vjeçar, në datën 02.07.2015. Burimi: të ardhurat nga paga. Akti noterial nr. 2213/936, datë 02.07.2015, para noterit L. D., Tiranë.*

37. Në DIPP-në e vitit 2015, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *hua në shumën 20.000 euro për blerje apartamenti në datën 02.07.2015 nga personi fizik A. K., me afat 10-vjeçar, pa interes.*

38. Në deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 2.7.2015, shtetasi A. K. ka deklaruar se i ka dhënë hua nëpërmjet transfertës bankare, në Raiffeisen Bank, shtetasit Desart Avdulaj, shumën 20.000 euro, pa interes dhe me afat deri në vitin 2025.

39. Komisioni, pas kontrollit të kësaj huaje, ka vlerësuar se *subjekti nuk ka arritur të provojë me dokumentacion ligjor të kundërtën e konstatimeve të Komisionit me barrën e provës në rezultatet e hetimit administrativ, duke mos provuar bindshëm mundësinë financiare të personit tjetër të lidhur, për dhënien e huasë në shumën 20.000 euro në vitin 2015.*

40. Komisioni, në arsyetimin e vendimit, ka konstatuar se huadhënësi A. K. ka realizuar të ardhura të konsiderueshme nga paga dhe nga dividendët si ortak në shoqërinë “{***}” ShPK, në një periudhë disavjeçare para dhënies së huasë. Komisioni, për periudhën 2008-2015, i ka njohur huadhënësit të ardhura nga paga, nga dividendi dhe të ardhura të tjera në shumën totale 46.353.956 lekë. Rezulton se Komisioni ka hetuar mënyrën se si personi tjetër i lidhur A. K. i ka përdorur këto të ardhura dhe, nga analizimi i gjetjeve të këtij hetimi, ka arritur në konkluzionin se ai nuk justifikon me burime të ligjshme shumën 20.000 euro, të dhënë hua subjektit të rivlerësimit.

¹⁶ Shkresë nr. {***} prot, datë 08.10.2020.

41. Subjekti i rivlerësimit e ka kundërshtuar si të pabazuar këtë konkluzion të Komisionit, duke pretenduar se me provat e paraqitura, ka provuar burimin e ligjshëm, si dhe mundësinë e dhënies së huasë në shumën 20.000 euro nga z. A. K.. Burimi i krijimit të kësaj huaje është deklaruar “*të ardhura nga paga*”, pasi ky ishte burimi që i ishte thënë nga personi tjetër i lidhur dhe, me dokumentacionin e dorëzuar, ka arritur të vërtetojë se personi tjetër i lidhur, vetëm për periudhën 2013-2015, ka pasur të ardhura nga paga në shumën 25.100.000 lekë (pa llogaritur tatimet mbi pagën). Sipas subjektit, vetë Komisioni ka konstatuar se në të njëjtën llogari nga ku është transferuar huaja, personi tjetër i lidhur ka pasur gjendje 26.922,06 euro. Në datën 26.06.2015, është depozituar *cash* shuma prej 20.000 eurosh, me përshkrimin “nga biznesi përmbartimor”, dhe po në të njëjtën ditë është transferuar shuma te subjekti i rivlerësimit. Në kuptim të parashikimeve të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, si dhe të qëndrimeve të Kolegjit, analizimi i burimit të huasë duhet të fokusohet në aspektin e ligjshmërisë së burimit dhe mundësisë financiare të personit tjetër të lidhur për dhënien e huasë. Subjekti pretendon se analiza financiare që Komisioni i ka bërë personit tjetër të lidhur është njësoj sikur ai të ishte subjekt vlerësimi, qëndrim që, sipas tij, bie ndesh me parashikimet ligjore dhe qëndrimin që Kolegji ka mbajtur në jurisprudencën e tij.
42. Trupi gjykues, pasi shqyrtoi aktet e fashikullit të çështjes dhe analizoi pretendimet e subjektit në raport me provat e marra nga Komisioni dhe arsyetimin e vendimit objekt kontrolli, konstatoi dhe vlerësoi si më poshtë.
43. Nga aktet e fashikullit të çështjes, provohet se personi tjetër i lidhur A. K., nga viti 2013¹⁷ deri në momentin e dhënies së huasë, kishte të ardhura financiare të ligjshme nga paga, dividendët dhe interesat bankarë në shumën prej 35.325.331 lekë. Trupi gjykues vlerëson se huadhënësi A. K. justifikon me burime financiare të ligjshme shumën prej 20.000 eurosh të dhënë hua subjektit të rivlerësimit, në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Në referencë të jurisprudencës së Kolegjit, trupi gjykues vlerëson se Komisioni duhej të përqendrohej te verifikimi i burimeve financiare të ligjshme të shtetasit A. K., si person tjetër i lidhur, pa u shtrirë ky verifikim edhe për investimet apo huadhëniet e tjera të tij.
44. Bazuar në analizën e mësipërme, trupi gjykues përfundimisht vlerësoi se është i bazuar pretendimi i subjektit të rivlerësimit se kjo hua duhet të konsiderohet si burim i ligjshëm në analizën financiare për krijimin e pasurisë apartament banimi, ndodhur në Rrugën e {***}, Tiranë.
- Në lidhje me huatë e marra nga vëllai K. A.:
- a) *Huaja e vitit 2015*
45. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, në rubrikën “Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë”: *hua e marrë për blerje apartamenti në shumën 10.000 euro, në datën 08.09.2015, me afat 10-vjeçar, pa interes*, ndërsa në rubrikën “Të dhëna konfidenciale” ka deklaruar: *hua e marrë nga vëllai K. A., pa interes, me afat 10-vjeçar, në datën*

¹⁷ Referuar periudhës së përcaktuar nga subjekti në ankim (2013-2015).

08.09.2015. Burimi: të ardhurat nga paga. Akti noterial nr. {***}, datë 08.09.2015, para noterit L. D., Tiranë.

46. Në DIPP-në e vitit 2015, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar hua në shumën 10.000 euro, për blerje apartamenti në datën 8.9.2015, nga personi fizik “K.A”, me afat 10-vjeçar, pa interes. Me deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 8.9.2015, me deklarues shtetasit K. A. dhe Desart Avdulaj, subjekti i rivlerësimit dhe vëllai i tij kanë konfirmuar detyrimin në formë huaje pa interes të shumës 10.000 euro, për një afat prej 10 vjetësh.
47. Komisioni, pas kontrollit të kësaj huaje, ka vlerësuar se *subjekti nuk ka arritur të provojë burimin e ligjshëm të personit tjetër të lidhur, shtetasit K. A. (vëllai i subjektit), për t’i dhënë hua shumën e pretenduar në vitin 2015.*
48. Komisioni e ka bazuar vlerësimin e mësipërm në konstatimet se: (i) disa prej dokumenteve shkresore të depozituara nga subjekti i rivlerësimit pas kalimit të barrës së provës, nuk kanë asnjë vlerë provuese në formën e paraqitur, sepse janë vetëdeklarime dhe të tjera dokumente nuk plotësojnë parashikimet e Konventës së Hagës, datë 5.10.1961, për heqjen e kërkesës së legalizimit për dokumentet publike të huaja, apo parashikimet e nenit 266 të Kodit të Procedurës Civile; (ii) me gjithë faktin se personi tjetër i lidhur dispononte vlera monetare në llogari bankare në vend, këto likuiditete deklaroi se kanë ardhur nga jashtë shtetit; (iii) pas kalimit të barrës së provës, subjekti ka ndryshuar/shtuar burimin e të ardhurave për huanë e dhënë nga vëllai K. A., duke përfshirë si burim edhe të ardhurat e së fejuarës/bashkëshortes së këtij të fundit, të cilat nuk janë deklaruar më parë nga subjekti dhe personi tjetër i lidhur dhe, për këtë arsye, Komisioni ka vlerësuar që ky burim mos të merret në konsideratë; (iv) në lidhje me të ardhurat e deklaruara në formë burse, përfituar nga Universiteti Charles, në Republikën Çeke, shpjegimet e subjektit kanë qenë të karakterit deklarativ, duke mos provuar shpenzimet reale të studimit, jetesës/qëndrimit për periudhën 2010-2014, si dhe pjesën e shpenzimeve të mbuluara nga kjo bursë; (v) në lidhje me të ardhurat nga grantet, subjekti i rivlerësimit nuk ka përcjellë kontratat e deklaruara të granteve, në vlerësim të deklarimeve të tij, jo e gjithë shuma e pretenduar e përfituar ka qenë për t’u përdorur nga vetë personi tjetër i lidhur, por një pjesë ka qenë në përdorim në udhëtime, konferenca ndërkombëtare, pajisje etj.; (vi) mundësia për kursim deri në fund të vitit 2015 vetëm e personit tjetër të lidhur, me të ardhurat e përfituara nga paga, do të rezultonte 132.909 CZK (620.631 CZK - 487.722 CZK) ose e konvertuar në vlerën 4.923 euro.
49. Komisioni ka mbajtur në konsideratë edhe faktin se huadhënësi K. A., përveç huasë së vitit 2015, i ka dhënë subjektit të rivlerësimit: (i) hua 10.000 euro në vitin 2010; dhe (ii) në huapërdorje në vitin 2011, automjetin tip “Mercedes Benz”, me targë {***}, në pronësi të tij.
50. Subjekti i rivlerësimit e ka kundërshtuar si të gabuar vlerësimin e Komisionit për këtë hua, bazuar në pretendimet se : (i) lidhur me vlerën provuese të dokumentacionit të paraqitur prej tij në cilësinë e provës, nuk aplikohen parashikimet e Konventës së Hagës¹⁸ dhe parashikimet e nenit 266 të Kodit

¹⁸ Konventën e Hagës së 5 tetorit 1961, lidhur me heqjen e kërkesës së legalizimit për të aktet publike të huaja.

të Procedurës Civile, për sa kohë ka një marrëveshje midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Çekisë për përjashtimin nga detyrimi i legalizimit të akteve të tyre publike, fakt i cili provohet nga faqja zyrtare e Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe ky dokumentacion është përkthyer nga një përkthyes zyrtare e miratuar nga Ministria e Drejtësisë; (ii) përfshirja e të ardhurave të së fejuarës së vëllait, e më pas bashkëshortes, tregon të kundërtën e konstatimeve të Komisionit, duke arritur të provojë të ardhurat e ligjshme për të dyja huatë e marra nga vëllai i tij; (iii) analiza që ai ka paraqitur në ankim, e të ardhurave dhe shpenzimeve të vëllait K. A. dhe bashkëshortes O. R., për periudhën 2008-2015, tregon se personi i tjetër i lidhur K. A. ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për huanë e vitit 2010 (kursime 18.693 euro) dhe për huanë e vitit 2015 (kursime 75.705 euro).

51. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkaku ankimi, nga verifikimi i akteve të fashikullit të përcjellë nga Komisioni, trupi gjykues konstaton se, referuar të dhënave bankare, rezulton se në datën 8.9.2015, vëllai i subjektit K. A. ka depozituar *cash* në llogarinë në euro të subjektit të rivlerësimit në Raiffeisen Bank, shumën 10.000 euro, me përshkrimin “dhënie huaje”. Kjo shumë rezulton të jetë kthyer në datë 4.8.2020, me transfertë bankare nga subjekti i rivlerësimit në Raiffeisen Bank.
52. Në përgjigje të pyetësorit nr. 3 të Komisionit, subjekti ka deklaruar se: *Huaja prej 10 mijë eurosh, e derdhur nga vëllai im në datën 08.09.2015, ka ardhur nga jashtë shtetit dorazi. E kanë sjellë ai së bashku me bashkëshorten, pasi kanë ardhur të dy atë vit për pushime në Shqipëri.*
53. Me deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka bashkëlidhur dokumentacion provues lidhur me burimet e krijimit të huasë: *i) vërtetim nga Universiteti Charles në Republikën e Çekisë, mbi bursat e marra nga vëllai i tij, për periudhën 2010-2014¹⁹; ii) vërtetim i datës 26.10.2016, lëshuar nga Instituti i Teorisë dhe Automatizimit Pragë, mbi pagat e marra për periudhën 2012-2015²⁰; iii) ekstrakt llogarie bankare i printuar në datën 16.10.2016 nga Banka Komerçni për periudhën nga data 17.10.2014 deri më datë 13.10.2016, në monedhën CZK (në gjuhën çeke). Gjatë hetimit administrativ, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti i rivlerësimit ka bashkëlidhur edhe: vërtetim nga Raiffeisen Bank ShA, datë 22.07.2019, nëpërmjet të cilit vërtetohet punësimi i vëllait të tij K. A. në këtë bankë, për periudhën 01.07.2005 - 20.02.2006, nga i cili rezulton se në momentin e largimit, *paga bazë mujore ka qenë 43.000 lekë*; vërtetim nga Credins Bank nr. {***} prot., datë 23.07.2019, nëpërmjet të cilit vërtetohet punësimi i vëllait të subjektit në këtë bankë, në periudhën 27.02.2006 - 24.08.2006, *me pagë bazë mujore bruto 65.000 lekë*; vërtetim mbi bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare nga Drejtoria e Arkivit Qendror Tiranë, nr. {***} prot., datë 14.08.2020, për të ardhurat e realizuara në Raiffeisen Bank dhe në Credins Bank, për periudhën korrik 2005 - gusht 2006.*

¹⁹ Konkretisht: në vitin 2010, shumën 6.050 CZK; në vitin 2011, shumën 77.950 CZK; në vitin 2012, shumën 95.500 CZK; në vitin 2013, shumën 114.100 CZK; në vitin 2014, shumën 17.200 CZK; si dhe grante 2010-2016, në shumën 422.238 CZK.

²⁰ Konkretisht: në vitin 2012, shuma neto 69.700 CZK; në vitin 2013, shuma 85.000 CZK; në vitin 2014, shuma 173.204 CZK; në vitin 2015, shuma 208.387 CZK.

54. Referuar akteve të fashikullit, rezulton se vëllai i subjektit K. A., për vitet 2012 deri 2015, ka përfituar të ardhura neto nga punësimi me vlerë 620.631 CZK, ndërsa referuar shpenzimeve dhe konsumit të familjeve²¹, Komisioni ka përlllogaritur se shpenzimet mesatare për frymë për të njëjtën periudhë janë rreth 487.722 CZK. Sipas Komisionit, mundësia e përfaqësit për kursim e vëllait K. A. është në shumën 132.909 CZK²² (620.631 CZK - 487.722 CZK) ose 4.923 euro²³. Në këtë përlllogaritje, nuk janë marrë parasysht bursat e marra për periudhën 2010 – 2014, si dhe grantet për periudhën 2010 – 2016, pasi, sipas Komisionit, ato nuk janë pjesë e burimit të të ardhurave të deklaruara për dhënien e kësaj huaje dhe se aktet e administruara nuk provojnë shpenzimet reale të studimit/jetesës/etj., për çdo vit, si dhe pjesën e shpenzimeve të mbuluara nga kjo bursë dhe, për këtë arsye, ato nuk janë përfshirë në analizë.
55. Trupi gjykues, pasi shqyrtoi aktet e fashikullit të çështjes dhe analizoi pretendimet e subjektit në raport me provat e marra nga Komisioni dhe arsyetimin e vendimit objekt kontrolli, konstatoi dhe vlerësoi si më poshtë.
56. Dokumentet e depozituara nga subjekti i rivlerësimit në Komision, të lëshuara në Republikën e Çekisë, janë paraqitur të përkthyer nga një përkthyes i miratuar nga Ministria e Drejtësisë, A.H., të palegalizuara dhe pa vulë *apostile*. Referuar informacionit në faqen zyrtare të MEPJ-së, rezulton se Republika e Çekisë dhe Republika e Shqipërisë, në kuadër të një marrëveshjeje dypalëshe, janë angazhuar për përdorimin e dokumenteve pa legalizim apo vulë *apostile*. Në këto kushte, dokumentacioni i paraqitur nga subjekti i rivlerësimit i përmbush kërkesat e ligjit për sa i përket formës.
57. Lidhur me qëndrimin e Komisionit për mospërfshirjen në analizën financiare për burimin e huasë të të ardhurave të bashkëshortes së personit tjetër të lidhur, pasi ato nuk janë deklaruar më parë nga subjekti, por subjekti ka ndryshuar/shtuar burimin e të ardhurave për huanë e dhënë nga vëllai pas dërgimit të rezultateve të hetimit, konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën *vetting*, si burim të huasë në vitin 2015, “të ardhurat nga paga”. Pas rezultateve të hetimit, subjekti ka pretenduar se si burim për krijimin e shumës 10.000 euro për dhënien e huasë nga vëllai i tij, duhet të përfshihen edhe të ardhurat e bashkëshortes së huadhënësit, çka është interpretuar nga Komisioni se subjekti ka ndryshuar/shtuar burimin e të ardhurave që kanë shërbyer për dhënien e huasë, trupi gjykues e vlerëson tepër formalist këtë qëndrimin të Komisionit dhe, si rrjedhojë, e gjen të bazuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit.
58. Në vijim, trupi gjykues kontrolloi konkluzionin e Komisionit për sa i përket verifikimit të burimeve financiare të personit tjetër të lidhur për krijimin e shumës së dhëna hua, bazuar në kërkesat e nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

²¹ Anketa e buxhetit të familjeve të zyrës së statistikave çeke: <https://www.czso.cz/csu/czso/expenditures-and-consumption-of-households-included-in-household-budget-survey-2011-q51s148bwb>.

²² Komisioni nuk ka llogaritur vlerat monetare gjendje në llogari bankare, si dhe pasuri, shpenzime të tjera të krijuara/kryera nga z. K. A. për këtë periudhë).

²³ Kursi këmbimit: 1 euro = 27 CZK.

59. Nga aktet e fashikullit të Komisionit, rezulton se subjekti ka paraqitur dokumentacion sa u përket të ardhurave nga paga të vëllait K. A. për periudhën 2011-2015, ndërkohë që për bashkëshorten O. R., dokumentacioni justifikues paraqet informacion për të ardhurat dhe shpenzimet për periudhën nga viti 2008 deri në vitin 2010, por nuk rezulton të ketë dokumentacion provues lidhur të ardhurat për periudhën nga viti 2011 deri në vitin 2015, sikurse ka pretenduar subjekti i rivlerësimit në shpjegimet pas rezultateve të hetimit dhe në analizën financiare të paraqitur në përmbajtje të ankimit të tij. Për sa më sipër, me të drejtë Komisioni ka analizuar vetëm të ardhurat e shtetasit K. A. për periudhën 2011-2015.
60. Në lidhje me të ardhurat nga bursa dhe grantet, të përfituara nga Universiteti Charles, për të cilat Komisioni ka vlerësuar se këto të ardhura kanë shërbyer për të përballuar shpenzimet bazë të jetesës, si dhe shpenzimet që lidhen me zhvillimin e anës profesionale të z. K. A., e si rrjedhojë nuk janë konsideruar në analizën financiare, trupi gjykues, në ndryshim nga Komisioni, vlerëson se në referencë edhe të jurisprudencës së Kolegjit lidhur me këtë kategori të ardhurash, konkretisht bursat konsiderohen si kuotë financiare për ushqim dhe shpenzimet bazë për jetesë të studentit, ndërkohë që grantet akordohen për mbështetjen e kërkimit shkencor dhe zhvillimin e anës profesionale. Subjekti i rivlerësimit dhe personi tjetër i lidhur, nëpërmjet dokumentacionit që provon përfitimin e bursën dhe granteve, kanë arritur të provojnë vetëm mundësinë e përballimit të shpenzimeve të jetesës dhe shpenzimeve për studime/kërkime shkencore nëpërmjet tyre, por pa identifikuar se në cilin nivel ato i kanë mbuluar këto shpenzime. Trupi gjykues vlerëson se ato duhet të merren në konsideratë si e ardhur për mbulimin e shpenzimeve të jetesës së personit tjetër të lidhur, por nuk përbëjnë provë në drejtim të mundësisë për kursim nga këto të ardhura në mënyrën e pretenduar nga subjekti i rivlerësimit. Për sa më sipër, lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit për përfshirjen në analizë financiare të të ardhurave nga bursa dhe grantet, trupi gjykues vlerëson se të ardhurat nga bursa duhet të konsiderohen si e ardhur që ka shërbyer për mbulimin e shpenzimeve të jetesës për personin tjetër të lidhur, z. K. A., i cili do të ngarkohet me shpenzime jetese vetëm për diferencën midis totalit të shpenzimeve të jetesës të llogaritura sipas anketës së buxhetit të familjeve të zyrës së statistikave çeke me totalin e përfituar nga bursa. Për sa u përket granteve të cilat kanë destinacion të përcaktuar për kërkim shkencor dhe zhvillim profesional dhe nuk lidhet me shpenzimet e jetesës, trupi gjykues vlerësoi se për sa kohë nuk ka informacion lidhur me shpenzimet reale që janë mbuluar me këto grante, ato nuk mund të përfshihen si e ardhur në analizën financiare.
61. Në lidhje me përlllogaritjen e shpenzimeve të jetesës, referuar anketës së buxhetit të familjeve të zyrës së statistikave çeke²⁴, rezultoi se shpenzimet mesatare për frymë për periudhën 2012 - gusht 2015, janë në shumën 446.825 CZK. Subjekti, në shpjegimet e dhëna në lidhje me rezultatet e hetimit, ka paraqitur si provë edhe dy kontrata për nënqiramarrje banese, për periudhën 15.05.2012 - 14.05.2015, në emër të vëllait K. A. dhe bashkëshortes së tij. Referuar këtyre kontratave, rezulton se qiraja (duke përfshirë edhe energjinë, ujë dhe mirëmbajtje) është në shumën 9.000 CZK/muaj. Sa

²⁴ Anketa e buxhetit të familjeve të zyrës së statistikave çeke: <https://www.czso.cz/csu/czso/expenditures-and-consumption-of-households-included-in-household-budget-survey-1st-quarter-of-2012-log2zdg0on>.

më sipër, për një llogaritje të saktë të totalit të shpenzimeve (shpenzime jetese dhe shpenzime qiraje), në ndryshim nga Komisioni²⁵, trupi gjykues përlllogaritë shumën e paguar të qirasë vetëm për diferencën e mbetur nga shuma totale e qirasë së paguar (duke e ndarë shumën e qirasë mujore në masën 50% me bashkëshorten), me shumën e rezultuar nga përqindja që zinte qiraja në vitet përkatëse në totalin e shpenzimeve të jetesës²⁶. Shpenzimet e z. K. A., për periudhën 2012 - gusht 2015, u përlllogaritën si diferencë e totalit të shpenzimeve me totalin e shumës së përfituar nga bursa. Nga analiza financiare e kryer në Kolegj nëpërmjet Njësisë së Shërbimit Ligjor, rezultoi se vëllai K. A., për periudhën 2012 - gusht 2015, ka pasur mundësi të kursente vetëm shumën 8.978 euro (totali i të ardhurave 20.414 euro – totali shpenzimeve 11.436 euro)²⁷, që do t'i takonte një mesatareje vjetore në shumën 2.565 euro, kursim ky minimalist duke konsideruar se, nëpërmjet tij, ai do të duhej të përballonte edhe shpenzime të tjera përveç shpenzimeve bazike për jetesë. Bazuar në sa më sipër, arrihet në përfundimin se subjekti, edhe pas konsiderimit të të ardhurave nga bursa dhe reduktimit të shpenzimeve të qirasë, përsëri nuk ka arritur të provojë bindshëm mundësinë financiare të personit tjetër të lidhur, z. K. A., për dhënien e huasë në shumën 10.000 euro në datën 08.09.2015, duke e bërë të pabesueshëm për trupin gjykues, që të gjitha kursimet e tij modeste për një periudhë rreth katërvjeçare ia dha hua subjektit të rivlerësimit për një afat 10-vjeçar dhe pa interes.

62. Në këto kushte, trupi gjykues, bazuar në analizën e mësipërme, arriti në konkluzionin se qëndrimi i Komisionit, sipas të cilit subjekti nuk arriti të provojë burimin e ligjshëm të të ardhurave të personit tjetër të lidhur, z. K. A., për t'i dhënë huanë e pretenduar në vitin 2015, në shumën 10.000 euro, dhe moskonsiderimin e kësaj huaje si burim për krijimin e pasurisë apartament banimi në Tiranë, është i drejtë.

b) Huaja e vitit 2010

63. Në deklaratën *vetting*, subjekti ka deklaruar: *Hua e pakonsumuar (shlyer) në shumën 10.000 euro, marrë në vitin 2010 për qëllime studimi master. Studimet nuk u kryen për arsye objektive. Huaja nga vëllai im K.A u bë me anë të transfertës bankare në llogarinë time në Raiffesisen Bank në datën 29.03.2010. Huaja u kthye përsëri me transfertë bankare nga llogaria ime më datë 30.05.2011 dhe 14.06.2011.*
64. Në DIPP-në e vitit 2010, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Detyrim në shumën 10.000 euro, të marra hua me transfertë bankare nga vëllai im që jeton në Çeki, me afat 1-vjeçar, pa interesa, për periudhën mars 2010 - maj 2011, për ndjekjen e një masteri në Itali. Masteri nuk u krye për arsye objektive. Shuma e pashlyer deri në datë 31.12.2010, është 10.000 euro.*

²⁵ Komisioni ka përlllogaritur vetëm shpenzimet e jetesës dhe jo shpenzimet e qirasë, sipas kontratave të depozituara nga subjekti.

²⁶ Referuar anketës së buxhetit të familjeve të zyrës së statistikave çeke, rezulton se përqindja mesatare që zë qiraja + energji + ujë + gaz është 21,8% në vitin 2012, 22,28% në vitin 2013, 22% në vitin 2014 dhe 22,4% në tremujorin e parë të vitit 2015.

²⁷ Referuar dokumentit nga Banka Nacionale Çeke, datë 30.08.2020, dorëzuar nga subjekti në pyetësorin nr. 2, kursi mesatar i këmbimit për vitin 2015, 1 euro = 27 CZK.

65. Në DIPP-në e vitit 2011, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Detyrim për studime në shumën 10.000 euro, ndaj vëllait tim K. A., rezident në Republikën Çeke, për periudhën mars 2010 - maj 2011. Afat kthimi 1-vjeçar, për studime masteri në Itali. Studimet nuk u zhvilluan nga ana ime për arsye objektive. Shuma 10.000 euro u shlye e gjitha. Ky detyrim, i papërdorur nga ana ime, iu transferua përsëri nga ana ime K. A., në llogarinë e tij, nëpërmjet Raiffeisen Bank, dega Gjirokastër, në datat 17.5.2011 dhe 30.5.2011.*
66. Referuar të dhënave bankare të Raiffeisen Bank, në llogarinë e subjektit në monedhën euro, rezulton se në datën 08.03.2010, nga vëllai K. A. është transferuar shuma 9.904,89 euro, pa përshkrim, e cila është tërhequr nga subjekti më datë 29.03.2010. Në vitin 2011, subjekti i rivlerësimit ka kryer dy transfertë në llogarinë bankare të vëllait K. A., në datë 30.05.2011 është kryer transfertë me vlerë 6.049,01 euro dhe në datë 14.06.2011 transfertë me vlerë 4.000 euro.
67. Subjekti, si në deklarinimin periodik të vitit 2010, ashtu edhe në deklaratën *vetting*, nuk ka deklaruar burimin e të ardhurave të huadhënësit për shumën 10.000 euro. Ndërkohë, gjatë hetimit administrativ²⁸, subjekti ka deklaruar se si burim për shumën e dhënë hua, kanë shërbyer të ardhurat nga puna e së fejuarës të vëllait të tij.
68. Komisioni, pas kontrollit të kësaj huaje, ka vlerësuar se *subjekti nuk ka arritur të provojë burimin e ligjshëm të personit tjetër të lidhur, shtetasit K. A. (vëllai i subjektit), për dhënien e huasë në shumën 10.000 euro në mars të vitit 2010.* Konkluzionin e mësipërm, Komisioni e ka bazuar në konstatimin për periudhën qershor 2008 – shkurt 2010, sipas të cilit mundësia për kursim e vëllait të subjektit K. A. dhe e së fejuarës së tij O. R., në shumën 181.767 CZK ose 6.732 euro, është e pamjaftueshme për të provuar mundësinë financiare të personit tjetër të lidhur K. A., për dhënien e huasë në shumën 10.000 euro, në mars të vitit 2010.
69. Ky vlerësim i Komisionit është kundërshtuar në ankim nga subjekti i rivlerësimit, duke pretenduar se dokumentacioni i paraqitur si provë në Komision, provon se vëllai K. A. ka pasur burime të ligjshme dhe mundësinë për të dhënë këtë hua.
70. Lidhur me këtë shkak ankimi, trupi gjykues, nëpërmjet Njësisë së Shërbimit Ligjor, kontrollon analizën financiare të Komisionit në lidhje me mundësinë financiare të personit tjetër të lidhur për dhënien e huasë. Konstatohet se Komisioni i ka përllogaritur shpenzimet e jetesës si për z. K. A., ashtu edhe për znj. O. R. duke filluar nga muaji korrik 2008, ndërkohë që, referuar deklarimeve të subjektit, vëllai i tij K. A. ka bashkëjetuar me znj. O. R., duke filluar nga tetori i vitit 2009. Në rast se në analizën financiare shpenzimet e jetesës për periudhën qershor 2008 - shtator 2009, llogariten vetëm për 1 person dhe për periudhën tetor 2009 deri në shkurt 2010 për dy persona, rezulton se

²⁸ Në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti ka deklaruar se: “Sa i përket burimit të të ardhurave për shumën e dhënë në datën 08.03.2010, burim janë të ardhurat nga puna e të fejuarës së tij në atë kohë (më vonë bashkëshortja) O. R., si mjeke në departamentin e ORL-së, Spitali Rajonal {***}, ku punon prej korrikut të vitit 2008.

huadhënësi K. A. ka pasur mundësi financiare të kursente shumë 12.565 euro²⁹, ndryshe nga sa ka rezultuar në analizën financiare të Komisionit, në shumë 6.732 euro. Bazuar në këtë vlerësim, personi tjetër i lidhur, z. K. A., ka pasur burime financiare të ligjshme për dhënien e huasë në mars të vitit 2010.

71. Në kushtet kur kjo hua nuk ka shërbyer si burim për krijimin e ndonjë pasurie, ky konkluzion do të mbahet në konsideratë vetëm për sa ka lidhje me shkaqet e ankimit për analizën financiare të subjektit të rivlerësimit për vitin 2011, të analizuar më poshtë në këtë vendim.
 - Në lidhje me kursimet *cash* në banesë për periudhën 2003-2015:
72. Në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit si një nga burimet për blerjen e apartamentit në Rrugën e {***}, Tiranë, ka deklaruar *kursime të ruajtura në shtëpi gjatë viteve, 31.880 euro*.
73. Komisioni, pas kontrollit të këtij burimi të deklaruar për krijimin e pasurisë apartament, ka vlerësuar se *subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë ligjshmërinë e likuiditeteve cash në banesë, prej 31.880 eurosh, pasi nga hetimi administrativ u provua vetëm vlera prej 2.641.157 lekësh e mundshme për t'u kursyer deri në datën 31.12.2014*.
74. Këtë vlerësim Komisioni e ka bërë pasi ka shqyrtuar deklaratimet periodike të subjektit të rivlerësimit për periudhën 2003-2015³⁰, deklaratimet në deklaratën *vetting* në lidhje me kursimet likuiditete në gjendje *cash*, si dhe pasi ka analizuar mundësinë financiare të subjektit dhe personit të lidhur për krijimin e tyre, duke u bazuar në konstatimet se: (i) subjekti, personi i lidhur dhe personat e tjerë të lidhur (familjarët e bashkëshortes) nuk kanë arritur të provojnë burimin e ligjshëm të të ardhurave për shumë 500.000 lekë, të deklaruara nga bashkëshortja e subjektit në deklaratën e interesave privatë të personit të lidhur si në deklaratën *vetting*, ashtu edhe në DPV-në e vitit 2009, si dhuratë monetare nga familjarët e saj me rastin e martesës në vitin 2009, e cila është përdorur si burim për

²⁹ Totali i të ardhurave, i përlllogaritur në shumë 20.539 euro – totalin e shpenzimeve, i përlllogaritur në shumë 7.974 euro. Kursi i këmbimit u përlllogarit referuar dokumentit nga Banka Nazionale Çeke, datë 30.08.2020, dorëzuar nga subjekti në pyetëtorin nr. 2, ku kursi mesatar i këmbimit për vitin 2010 ishte 1 euro = 26 CZK.

³⁰ Subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, në lidhje me kursimet gjendje *cash*, në deklaratat periodike vjetore kanë deklaruar: (i) në deklarimin për herë të parë në datën 31.3.2004, subjekti nuk deklaroi kursime gjendje *cash*; (ii) në DIPP-në e vitit 2004, subjekti nuk deklaroi kursime *cash*; (iii) në DIPP-2005, subjekti nuk deklaroi kursime *cash*; (iv) në DPV-në e vitit 2006, subjekti deklaroi gjendje *cash* në banesë në shumë 150.000 lekë; (v) në DIPP-në 2007, subjekti deklaroi kursime *cash* në banesë në shumë 200.000 lekë; (vi) në DIPP-2008, subjekti deklaroi kursime të mbajtura në banesë në shumë 300.000 lekë nga të ardhurat e vitit 2008; (vii) në DIPP-2009, subjekti deklaroi kursime (të ruajtura në banesë) në shumë 500.000 lekë, ndërsa bashkëshortja, në deklaratën e interesave privatë të personit të lidhur, deklaroi dhuratë monetare me rastin e martesës nga familja dhe të afërmit (të ruajtura në banesë) në shumë 500.000 lekë, kursime nga puna si specialiste audit në Këshillin e Qarkut Gjirokastër (të ruajtura në banesë) në shumë 500.000 lekë, pjesa në përqindje 100%; (viii) në DIPP-2010, subjekti deklaroi kursime (të ruajtura në banesë) në shumë 500.000 lekë; (ix) në DIPP-2011, subjekti deklaroi kursime të ruajtura në banesë në shumë 450.000 lekë; (x) në DIPP-2012, subjekti deklaroi kursime të ruajtura në banesë në shumë 800.000 lekë; (xi) në DIPP-2013, subjekti deklaroi kursime të ruajtura në banesë në shumë 1.000.000 lekë; (xii) në DIPP-2014, subjekti deklaroi kursime të ruajtura në banesë për vitin 2014, në shumë 1.200.000 lekë; (xiii) në DIPP-2015, subjekti deklaroi kursime të ruajtura në banesë në shumë 1.250.000 lekë nga të ardhurat nga pagat.

blerje të pasurisë së paluajtshme apartament në Tiranë në vitin 2015; (ii) subjekti nuk arriti të dokumentojë burimin e ligjshëm të të ardhurave të bashkëshortes për kursimin e shumës 500.000 lekë, të deklaruara në deklaratën e interesave privatë të personit të lidhur në DPV-në e vitit 2009, si edhe në deklaratën *vetting*, e cila është përdorur si burim për blerje të pasurisë së paluajtshme apartament në Tiranë në vitin 2015, për sa kohë subjekti nuk provoi as kërkesat specifike që kërkon dispozita ligjore, neni 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016; (iii) nga analiza e treguesve financiarë për sa u përket kursimeve të deklaruara si gjendje *cash* në vitet 2008, 2011, 2012 dhe 2013, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë pasur burime të mjaftueshme financiare për këto kursime, me total të balancave negative në vlerën 2.337.812 lekë.

75. Subjekti i rivlerësimit e ka kundërshtuar këtë vlerësim të Komisionit duke pretenduar se shuma prej 500.000 lekësh (dhurime nga familjarët dhe të afërmit e bashkëshortes me rastin e martesës), si edhe shuma prej 500.000 lekësh (kursime nga paga e bashkëshortes), deklaruar gjendje *cash* në vitin 2009, duhet të konsiderohen si burim për blerjen e pasurisë apartament në Tiranë. Subjekti pretendon se gjendja *cash* në fund të vitit 2014 ka qenë në shumën 6.100.000 lekë, sipas deklarimeve të tij në deklaratat periodike vjetore dhe jo sipas vlerësimit të bërë nga Komisioni³¹. Subjekti i rivlerësimit kundërshton edhe analizën financiare të Komisionit për vitin 2011 në lidhje me shumën 10.000 euro të marrë hua në muajin mars 2010 nga vëllai i tij K. A. dhe të kthyer në vitin 2011, duke pretenduar se si burim për kthimin e saj ka qenë vetë shuma e marrë hua në vitin 2010, pasi ajo ngeli e përdorur deri në momentin e kthimit.
76. Trupi gjykues, pasi shqyrtoi aktet e fashikullit të çështjes dhe analizoi pretendimet e subjektit në raport me provat e marra nga Komisioni dhe arsyetimin e vendimit objekt kontrolli, konstatoi dhe vlerësoi si më poshtë.
77. Personi i lidhur i subjektit të rivlerësimit (bashkëshortja) J. A. ka deklaruar në deklaratën *vetting*, në rubrikën “Deklarimi i pasurive”: (i) dhuratë nga familjarët e mi me rastin e martesës në vitin 2009, vlera 500.000 lekë; (ii) kursime personale nga puna para martesës së vitit 2009, vlera 500.000 lekë.
78. Në DIPP-2009, bashkëshortja e subjektit ka deklaruar: *Dhuratë monetare me rastin e martesës nga familja dhe të afërmit (të ruajtura në shtëpi), shuma 500.000 lekë; kursime nga puna si specialiste auditi në Këshillin e Qarkut Gjirokastër (të ruajtura në shtëpi), shuma 500.000 lekë.*
79. Gjatë hetimit administrativ në Komision, në përgjigje të pyetësorit nr. 3, subjekti ka shpjeguar se: *sa i përket burimit të shumës kursime prej 500.000 lekësh, rezulton paga nga puna në Këshillin e Qarkut Gjirokastër. Rezulton se bashkëshortja ime ka nisur punë në muajin dhjetor 2007 dhe deri në muajin prill 2009, ka kursyer shumën e mësipërme nga paga e saj. Sa i përket burimit të dhuratës prej 500.000 lekësh nga familja me rastin e martesës, burim janë kursimet e tyre nga të ardhurat e*

³¹ Subjekti ka kryer një analizë financiare për vitet që Komisionit i kanë rezultuar me balancë negative dhe që kanë ndikuar në analizimin e mundësisë për kursim të gjendjes *cash* të deklaruar. Analiza financiare për vitet 2008, 2011, 2012 dhe 2013.

përbashkëta të familjes nga punësimi i babait, nënës, pensioni i gjyshes së ndjerë dhe nga një pjesë e të ardhurave para martesës që bashkëshortja ime ka kontribuar kur jetonte me familjarët.

80. Komisioni, pasi ka kryer analizën financiare si të bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, ashtu edhe të familjes së saj, ka konstatuar se bashkëshortja ka qenë në pamundësi financiare për kursimin nga paga të shumës 500.000 lekë para martesës dhe po ashtu edhe familja e saj ka qenë në pamundësi financiare për t'i dhuruar asaj shumën prej 500.000 lekësh me rastin e martesës në datën 30.04.2009. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar gjatë procesit në Komision, se shuma prej 500.000 lekësh, dhuruar bashkëshortes me rastin e martesës, përbëhet nga 375.000 lekë të dhuruara nga familjarët dhe shoqëria e saj me rastin e martesës, provuar nëpërmjet deklaratave noteriale³², dhe pjesa tjetër prej 125.000 lekësh është krijuar nga të ardhurat nga paga e nënës së bashkëshortes dhe pjesërisht nga të ardhurat nga shitja e prodhimeve bujqësore, pasi familja e bashkëshortes jeton në fshat dhe ka në pronësi tokë bujqësore.
81. Trupi gjykues konstaton se për periudhën 01.01.2008 - 30.04.2009, totali i të ardhurave nga paga e prindërve të bashkëshortes, rezulton 411.209 lekë, ndërsa vetëm shpenzimet e jetesës për familjen me pesë anëtarë përlllogariten në shumën 910.800 lekë. Pavarësisht se familja e bashkëshortes ka jetuar në fshat, shpenzimet e jetesës, referuar të dhënave të INSTAT-it, janë shpenzime minimale jetike, si rrjedhojë, nuk qëndron pretendimi i subjektit për reduktimin në analizën financiare të shpenzimeve të jetesës. Në këto kushte, edhe nëse do të pranohet pretendimin e subjektit se shpenzimet e jetesës në fshat janë më të ulëta, përsëri është evidente se prindërit e bashkëshortes, me të ardhurat nga pagat e tyre, nuk mund të përballonin dot shpenzimet e jetesës për të gjithë familjen me pesë anëtarë, shpenzimet e udhëtimit të vajzës së tyre, si dhe t'i kursenin asaj pagën.
82. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit, për standarde të ndryshme të Komisionit në çështjen e tij sa i takon trajtimin e të ardhurave nga prodhimet bujqësore, trupi gjykues vlerëson se, referuar jurisprudencës së Kolegjit, pretendime të tilla të subjekteve të rivlerësimit nuk mund të përbëjnë *a priori* shkak për të konsideruar të padrejtë vendimin e Komisionit. Çdo vendimmarrje e Komisionit vlerësohet nga Kolegji në mënyrë individuale, bazuar në specifikat e rrethanave faktike të provuara nga gjykimi dhe në zbatimin e duhur të ligjit sipas situatës konkrete faktike, dhe jo nga mënyra se si mund të jenë rivlerësuar subjektet e tjera të rivlerësimit nga Komisioni. Sa më sipër, pretendimi i subjektit vlerësohet i pambështetur.
83. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se është në pamundësi objektive për të paraqitur dokumentacion provues mbi sasinë e prodhimeve bujqësore dhe medicinale dhe të ardhurave të realizuara prej tyre nga familja e bashkëshortes para martesës së saj dhe, për këtë situatë, duhet të aplikohet nga Kolegji neni 32, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues e gjen të pabazuar këtë pretendim pasi ky dokumentacion nuk rezulton të ketë ekzistuar ndonjëherë.
84. Lidhur me pretendimin e subjektit se një pjesë e shumës së dhuruar me rastin e martesës, konkretisht shuma 375.000 lekë, është përfituar në formën e dhurimeve nga familjarët, të afërmit

³² Deklarata noteriale nr. {***}, datë 06.05.2021; nr. {***}, datë {***}; nr. {***}, datë 06.05.2021.

dhe shoqëria me rastin e martesës, trupi gjykues konstaton se në deklaratën *vetting* dhe në DIPP-në e vitit 2009, subjekti dhe bashkëshortja e tij nuk kanë deklaruar persona të tjerë si burim për krijimin e shumës së dhuruar, përveç familjarëve dhe të afërmeve, dhe vetëm pas rezultateve të hetimit, subjekti ka paraqitur disa deklarata noteriale nga persona të rrethit shoqëror të bashkëshortes, nëpërmjet të cilave pretendon të provojë burimin e shumës prej 375.000 lekësh. Në lidhje me sa më sipër, trupi gjykues mban në konsideratë se fuqia provuese e deklaratave noteriale të paraqitura gjatë procesit të rivlerësimit, është një çështje që ka gjetur trajtim të gjerë në jurisprudencën e Kolegjit, sipas së cilës deklaratat noteriale të paraqitura gjatë procesit të rivlerësimit, nëpërmjet të cilave kërkohet të provohen apo vërtetohen deklarime të vetë subjektit, në kontekstin e procesit të rivlerësimit, përbëjnë akte me vlerë të kufizuar provuese nëse nuk mbështeten nga prova të tjera.

85. Bazuar në analizën e mësipërme, trupi gjykues e gjen të drejtë qëndrimin e Komisionit për të mos konsideruar të dyja shumat prej 500.000 lekësh të deklaruara si kursime të bashkëshortes së subjektit në vitin 2009, si burime me të ardhura financiare të ligjshme për blerjen e apartamentit në Tiranë.
86. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në ankim një analizë financiare për vitet që Komisionit i kanë rezultuar me balancë negative (vitet 2008, 2011, 2012 dhe 2013) dhe që kanë ndikuar në analizimin e mundësisë për kursim të gjendjes *cash* të përdorur për blerjen e apartamentit në Tiranë, duke pretenduar se: (i) në analizën financiare për vitin 2011, Komisioni e ka llogaritur si shpenzim nga të ardhurat e këtij viti, kthimin e shumës 10.000 euro të marrë hua nga vëllai i tij K. A. në vitin 2010, megjithëse ai e ka deklaruar qartë se këtë shumë nuk e ka përdorur dhe ia ka kthyer atij në vitin 2011; (ii) për vitin 2013, Komisioni nuk ka përllogaritur të ardhurat e bashkëshortes nga Qendra Komunitare Gjirokastër, në vlerën 175.000 lekë, dhe se zëri “shpenzime transporti i brendshëm (Tiranë-Durrës dhe kthim)”, sipas subjektit, nuk duhet të përllogaritet si shpenzim; (iii) diferencat negative të konstatuara nuk duhet të llogariten për pakësimin e likuiditetit *cash* pasi kështu rëndojnë dy herë analizën, një herë në analizën e përgjithshme dhe një herë duke pakësuar gjendjen *cash* për blerjen e apartamentit.
87. Lidhur me pretendimin e subjektit për analizën financiare të vitit 2011, trupi gjykues konstatoi se Komisioni, kthimin nga subjekti të huasë 10.000 euro ndaj vëllait K. A. e ka konsideruar si shpenzim nga të ardhurat e këtij viti dhe, si rrjedhojë, ky vit ka rezultuar me balancë negative prej (-) 1.326.811 lekësh. Komisioni e ka mbajtur këtë qëndrim pasi ka konstatuar se subjekti nuk e ka deklaruar shumën e huasë prej 10.000 eurosh si gjendje *cash* në fund të vitit 2010, duke e konsideruar të shpenzuar në atë vit. Lidhur me marrjen dhe kthimin e huasë, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën *vetting*: *Hua e pakonsumuar (shlyer) në shumën 10.000 euro, marrë në vitin 2010, për qëllime studimi master. Studimet nuk u kryen për arsye objektive [...].* Në DIPP-2010, subjekti ka deklaruar: *Detyrim në shumën 10.000 euro, të marra hua me transfertë bankare nga vëllai im që jeton në Çeki, me afat 1-vjeçar, pa interesa, për periudhën mars 2010 - maj 2011, për ndjekjen e një masteri në Itali. Masteri nuk u krye për arsye objektive. Shuma e pashlyer deri në datë 31.12.2010, është 10.000 euro.* Ndërsa në DIPP-2011, subjekti ka deklaruar: *Detyrim për*

*studime në shumën 10.000 euro, ndaj vëllait tim K. A., rezident në Republikën Çeke, për periudhën mars 2010 - maj 2011. Afat kthimi 1-vjeçar, për studime masteri në Itali. Studimet nuk u zhvilluan nga ana ime për arsye objektive. Shuma 10.000 euro u shlye e gjitha. Ky detyrim, i papërdorur nga ana ime, iu transferua përsëri nga ana ime K. A., në llogarinë e tij, nëpërmjet Raiffeisen Bank, dega Gjirokastrë; në datat 17.5.2011 dhe 30.5.2011. Referuar të dhënave nga Raiffeisen Bank, rezultoi se në llogarinë e subjektit në monedhën euro, në datën 08.03.2010 është transferuar shuma 9.904,89 euro, pa përshkrim, nga vëllai K. A.. Në datën 29.03.2010, subjekti ka tërhequr *cash* shumën 9.901 euro. Në vitin 2011, nga subjekti i rivlerësimit janë kryer dy transferta në llogarinë bankare të vëllait K. A., në datë 30.05.2011 është kryer transfera me vlerë 6.049,01 euro, dhe në datë 14.06.2011 transfera me vlerë 4.000 euro.*

88. Trupi gjykues analizoi pretendimet e subjektit të rivlerësimit në këndvështrim të parashikimeve të ligjit nr. 9049/2003 “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 9049/2003”) dhe situatës faktike konkrete. Sipas parashikimeve të nenit 4 të ligjit nr. 9049/2003, subjektet deklaruese kanë detyrimin të deklarojnë çdo shtesë të pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme, duke e përshkruar atë hollësisht dhe burimin e krijimit të saj. Sa më sipër, nga vlerësimi që u bëhet deklaratave periodike, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar shumën 9.904 euro, marrë në formën e huasë, si gjendje *cash* në fund të vitit 2010, megjithatë ai e ka deklaruar këtë hua të marrë nga personi tjetër i lidhur si dhe qëllimin për marrjen e saj, duke deklaruar gjithashtu në të njëjtin vit se qëllimi i marrjes së kësaj huaje nuk u realizua për arsye objektive dhe se detyrimi kundrejt huadhënësit deri në datë 31.12.2010, është i pashlyer. Po ashtu, trupi gjykues konstaton se, referuar DIPP-2011, subjekti i rivlerësimit në vijim dhe në koherencë të plotë me deklaratimet e kryera në vitin 2010, ka deklaruar edhe një herë detyrimin në shumën 10.000 euro, qëllimin e huasë, si dhe shlyerjen e kësaj huaje si detyrim të papërdorur nga ana e tij. Në këtë situatë faktike, pavarësisht konstatimit se subjekti nuk ka plotësuar kërkesën e nenit 4, paragrafi i parë i ligjit nr. 9043/2003, për shkak të mosdeklarimit të huasë së marrë në vitin 2010 si gjendje *cash* në vitin 2010, apo pakësimit të këtij likuiditeti në vitin 2011, trupi gjykues çmon se kjo mangësi në zbatimin e ligjit nuk mund të shërbejë si shkak për ngarkimin e subjektit të rivlerësimit me shpenzime për shlyerjen e saj në vitin 2011. Në arritjen e këtij konkluzioni, trupi gjykues mban në konsideratë edhe përfundimin e arritur më sipër në këtë vendim, se subjekti i rivlerësimit ka arritur të provojë ligjshmërinë e burimit të krijimit të kësaj huaje dhe mundësinë financiare të personit tjetër të lidhur K. A. për dhënien e huasë në shumën 10.000 euro në vitin 2010 për qëllime studimi. Për rrjedhojë, nga mosllogaritja e kthimit të huasë si shpenzim në vitin 2011, analiza financiare ndryshon nga balanca negative (-) 1.326.811 lekë, në balancën pozitive 53.435 lekë. Bazuar nga sa më sipër, subjekti i rivlerësimit në vitin 2011 rezultoi me mundësi financiare për të blerë armën e gjahut në vlerën 114.000 lekë, për të blerë automjetin tip “Renault Clio” në vlerën 420.000 lekë, si dhe për të kursyer likuiditetin *cash* në vlerën 450.000 lekë. Bazuar në konkluzionin e mësipërm, trupi gjykues i jep përgjigje edhe shkakut të ankimit që lidhet me pasurinë automjet, tip “Renault Clio”, dhe armë gjahu, duke pranuar si të drejta pretendimet e subjektit të rivlerësimit se këto pasuri janë krijuar me burime financiare të ligjshme.

89. Lidhur me pretendimin e subjektit për mospërlllogaritje në analizën financiare të vitit 2013, të të ardhurave të deklaruara nga bashkëshortja e subjektit në DIPP-2013, në shumën 175.000 lekë, për të cilat Komisioni ka vlerësuar se nuk duhet të përfshihen në analizë financiare, pasi nuk përmbushin standardin e së ardhurës së ligjshme, për shkak se nuk u arrit të provohej pagesa e detyrimeve tatimore, trupi gjykues konstaton se bashkëshortja e subjektit ka deklaruar në DIPP-2013, të ardhura nga punësimi pranë Qendrës Komunitare Multifunkionale Gjirokastër, për periudhën 01.01.2013 - 31.05.2013, në vlerën totale 175.000 lekë. Referuar vërtetimit, datë 21.03.2014, lëshuar nga kjo qendër, vërtetohet se znj. J. A. ka punuar me kontratë shërbimi për periudhën 1 janar deri më 31 maj 2013, dhe është paguar me pagë *neto* 35.000 lekë/muaj. Nga të dhënat bankare në Intesa SanPaolo Bank, evidentohen pesë transfertat bankare me vlerë totale 173.250 lekë, megjithatë, për këto të ardhura nuk rezultojnë të jenë dokumentuar pagesat e detyrimeve tatimore as nga bashkëshortja e subjektit dhe as nga punëdhënësi. Bazuar në konstatimet si më sipër, trupi gjykues e vlerëson të drejtë qëndrimin e Komisionit për të mos i konsideruar ato si të ardhura të ligjshme në kuptim të parashikimeve të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe të pikës 19 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016.
90. Lidhur me pretendimin e subjektit për mospërlllogaritjen e shpenzimeve të transportit për udhëtimet Tiranë-Durrës, pasi, sipas tij, ai nuk ka kryer shpenzime për arsye pune, trupi gjykues vlerësoi se ky pretendim i subjektit të rivlerësimit nuk qëndron pasi, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, pyetja nr. 8, vetë subjekti ka deklaruar se ka udhëtuar me makinën e një kolegu dhe ka paguar shpenzime karburanti në vlerën 1.500 - 2.000 lekë/muaj. Në lidhje me përlllogaritjen e shpenzimeve për udhëtimet vajtje-ardhje Tiranë-Durrës, trupi gjykues vlerëson se Komisioni i ka përlllogaritur saktë këto shpenzime. Sa më sipër, pretendimi i subjektit se nuk ka pasur shpenzime për udhëtimet, vlerësohet i pambështetur.
91. Në lidhje me pretendimet e subjektit për përlllogaritjen si të ardhur në analizën financiare të vitit 2013, të vlerës 41.000 lekë, të përfituar si dëmshpërblim “kasko”, nga shoqëria e sigurimeve “{***}” ShA, trupi gjykues e gjen të drejtë vlerësimin e Komisionit se ato janë rimbursim për një shpenzim të kryer për riparimin e automjetit dhe, si rrjedhojë, nuk mund të llogariten si të ardhur që mbulon shpenzime të tjera.
92. Bazuar në konstatimet e mësipërme, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka rezultuar me pamundësi për krijimin e gjendjes *cash* të deklaruar në vitet 2008, 2012 dhe vitin 2013, ku totali i balancave negative rezultojnë të jetë në shumën 982.032 lekë³³. Sa i takon pretendimit të subjektit të rivlerësimit se diferencat negative nuk duhet të llogariten një herë në analizën e përgjithshme dhe një herë duke pakësuar gjendjen *cash* për blerjen e apartamentit, pasi rëndojnë dy herë analizën, trupi gjykues vlerëson se ky pretendim është i pabazuar pasi analiza financiare është kryer për të verifikuar mundësinë e subjektit për të kursyer vlerën *cash* të deklaruar si burim për blerjen e pasurisë apartament në Tiranë.

³³ Balanca negative në vitin 2008, ka rezultuar në shumën (-) 189.168 lekë; në vitin 2012, ka rezultuar në shumën (-) 361.463 lekë; dhe në vitin 2013, ka rezultuar në shumën (-) 431.401 lekë.

93. Pas analizimit të mundësisë së krijimit të gjendjes *cash* deri më 31.12.2014, e përdorur si burim për blerjen e pasurisë apartament banimi në Rrugën e {***}, Tiranë, trupi gjykues konstatoi se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi financiare për të kursyer likuiditete *cash* në banesë deri në datë 31.12.2014, shumën 3.967.968 lekë³⁴, e cila është e pamjaftueshme për pagesën e shumës 31.880 euro (ekuivalenti 4.376.486 lekë) të deklaruar si burim për pagesën e një pjese të çmimit për blerjen e apartamentit në Rrugën e {***}, Tiranë.
94. Në përfundim të vlerësimit të burimeve financiare të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit për blerjen e pasurisë apartament në Tiranë, trupi gjykues, në ndryshim nga Komisioni, vlerësoi të konsiderojë si burim financiar të ligjshëm huanë e marrë nga shtetasi A. K. në shumën 20.000 euro, dhe kursimet e mundshme gjendje *cash* deri në datën 31.12.2014, të llogaritura në shumën 3.967.968 lekë. Bazuar në sa më sipër, pas korrigjimit të analizës financiare të Komisionit për periudhën 01.01.2015 - 31.12.2015, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme në shumën (-) 4.549.732 lekë, për të justifikuar pasurinë apartament banimi me sipërfaqe 169,8 m², në Tiranë, krijimin e likuiditeteve *cash* në banesë në vlerën 1.250.000 lekë, si dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera familjare për këtë periudhë. Për sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se, lidhur me pasurinë “apartament banimi” me sipërfaqe 169,8 m², të ndodhur në Rrugën e {***}, Tiranë, subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për justifikimin e saj, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.
- Në lidhje me automjetin “Mercedes Benz”:
95. Subjekti i rivlerësimit kundërshton si të gabuar vlerësimin e Komisionit për këtë pasuri, se: (i) nga subjekti i rivlerësimit, është kryer fshehje e kësaj pasurie në kuptim të parashikimeve të pikave 1, 3 dhe 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe germës “c” të pikës 5 të nenit 33 dhe pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016; dhe (ii) veprimet e subjektit të rivlerësimit përbëjnë zgjedhje të cilat jo vetëm nuk shërbejnë në krijimin e besimit të publikut te drejtësia, por e dëmtojnë atë, në kuptim të parashikimeve të pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.
96. Komisioni e ka bazuar këtë vlerësim në konstatimet se: (i) subjekti i rivlerësimit e ka përdorur automjetin edhe para datës 17.10.2011, kur është lidhur kontrata e huapërdorjes së tij; (ii) subjekti i rivlerësimit ka një marrëdhënie përdorimi të dokumentuar prej rreth 7 vjetësh me këtë pasuri; (iii) nuk gjenden bindëse argumentet e subjektit të rivlerësimit për burimin e të ardhurave të vëllait K. A. për blerjen e automjetit duke i marrë hua një të afërmi në Angli; (iv) subjekti i rivlerësimit e ka përdorur automjetin për një kohë të gjatë, pa kundërshtuar dhe pa ndërprerje; (v) subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar në asnjë nga deklaratimet periodike vjetore këtë huapërdorje.
97. Subjekti i rivlerësimit e ka kundërshtuar nëpërmjet ankimit këtë vlerësim të Komisionit, duke pretenduar se: (i) arsyeja e mosdeklarimit të përdorimit të këtij mjete në deklaratat periodike vjetore, lidhet me faktin se ligji i kohës nuk e parashikonte deklarimin e një sendi të luajtshëm në përdorim

³⁴ [6.100.000 - (150.000 + 1.000.000 + 982.032)]

dhe se në kushtet kur e përdorte atë pa kundërshpërblim, nuk mund ta deklaronte as si detyrim financiar ndaj huadhënësit; (ii) automjeti do të konsiderohej i fshehur nëse nuk do të ishte lënë asnjë gjurmë për përdorimin e tij nga ana e subjektit të rivlerësimit, ndërkohë që subjekti jo vetëm ka lënë gjurmë, por huapërdorja është regjistruar në regjistra publikë të kontrollueshëm, të mbajtur nga noteri; (iii) Komisioni e konsideron subjektin e rivlerësimit përdorues ekskluziv, ndërkohë që ai ka provuar se përdorues të këtij mjete janë edhe babai dhe vëllai i tij J. A.; (iii) vëllai i tij K. A. e ka blerë këtë automjet me një hua nga kushëriri Gj. A., i cili ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për dhënien e huasë; (iv) siguracioni në emër të tij nuk tregon domosdoshmëri qenien pronar; (iv) Komisioni ka arritur në konkluzione jo të drejta, duke shtrembëruar provat dhe rrethanat, si dhe duke mos marrë në konsideratë provat e paraqitura prej tij në lidhje me burimin e krijimit të kësaj pasurie.

98. Lidhur me këtë shkak ankimi, trupi gjykues, nga shqyrtimi i akteve të fashikullit të Komisionit dhe arsyetimi i vendimit objekt kontrolli, konstatoi dhe vlerësoi si më poshtë.
99. Subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar përdorimin e këtij automjeti në deklaratën *vetting: Përdorimi pa pagesë i autoveturës së vëllait tim K.A., për periudhën 2011 e në vazhdim, me targë {***}. Kontratë nr. {***}, datë 17.10.2011, para noter G. Sh., Tiranë*, duke bashkëlidhur edhe kontratën e huapërdorjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.10.2011, nuk rezulton të ketë deklaruar mbi burimin e krijimit të kësaj pasurie.
100. Rezulton se subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar në deklaratat periodike vjetore përdorimin e këtij automjeti. Bazuar në ligjin nr. 9049, datë 10.04.2003, i ndryshuar, detyrimi i subjekteve deklaruese për deklarimin e pasurive të luajtshme në përdorim, ka filluar pas ndryshimeve të tij me ligjin nr. 42/2017, i cili ka përcaktuar se objekt deklarimi do të jenë edhe pasuritë e luajtshme të regjistrueshme në regjistrat publikë, si dhe të drejtat reale mbi to. Në këto kushte, rezulton se subjektit i rivlerësimit nuk e ka pasur para vitit 2017, detyrimin për të deklaruar në DIPP-të vjetore përdorimin e këtij automjeti. Për sa më sipër, përfundimi i Komisionit se subjekti nuk ka deklaruar marrëdhënien e përdorimit në përputhje me përcaktimet ligjore në deklaratimet vjetore pranë ILDKPKI-së, është një përfundim i pambështetur në ligj.
101. Nga të dhënat e DPSHTRR-së, rezulton se shtetasi K. A., i përfaqësuar nga vëllai i tij J. A.³⁵, ka blerë me kontratë shitjeje nr. {***} rep., nr. {***} kol, datë 28.9.2010, në çmimin 17.000 euro, automjetin tip “Daimler AG MB 163”, me vit prodhimi 2005, ngjyrë gri, me naftë. Subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion ligjor që tregon se si është transferuar shuma 17.000 euro nga blerësi K. A., i cili jetonte në Pragë, Çeki, në drejtim të përfaqësuesit J. A., për kryerjen e pagesës së çmimit për blerjen e automjetit.
102. Automjeti është regjistruar fillimisht në datën 13.10.2010, me targë {***}, dhe në datën 10.10.2011 targa është ndryshuar në {***}.

³⁵ *Prokura e përgjithshme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 17.11.2009.*

103. Me kontratë huapërdorje automjeti³⁶, më datë 17.10.2011, shtetasi K. A., përfaqësuar nga vëllai J. A., i ka dhënë në huapërdorje automjetin me targë {***}, subjektit të rivlerësimit, me të drejtë përdorimi brenda dhe jashtë vendit, pa kundërshtpërblim, për një periudhë të përcaktuar deri në 1 vit.
104. Referuar të dhënave nga Raiffeisen Bank, në llogarinë e pagës së subjektit, më datë 16.8.2011, është kredituar shuma prej 166.100 lekësh nga kompania e sigurimit “{***}” ShA, me përshkrimin “dëmi Desart Avdulaj, kasko {***}”, që përkon me një datë para se të lidhej kontrata e huapërdorjes.
105. Referuar të dhënave nga AMF³⁷, rezulton se në policat e sigurimit nr. {***}, datë 20.10.2015; nr. {***}, datë 20.10.2016; nr. {***}, datë 19.10.2017, të shoqërisë “{***}” ShA, përdorues i këtij automjeti vazhdon të pasqyrohet subjekti i rivlerësimit.
106. Ndonëse fillimisht Komisioni ka vlerësuar se subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, për shkak të marrëdhënies së huapërdorjes me vëllain e tij K. A., në vlerësimin e trupit gjykues, kontrolli i ligjshmërisë së kësaj pasurie legjitimohet për shkak të dyshimeve të ngritura më pas për fshehje të saj.
107. Në kuadër të hetimit administrativ në lidhje me burimin e krijimit të pasurisë objekt shqyrtimi, Komisioni i është drejtuar subjektit të rivlerësimit nëpërmjet pyetësorit nr. 3³⁸, duke i kërkuar deklarinimin e burimit të të ardhurave që kanë shërbyer për blerjen e këtij automjeti. Në përgjigje të këtij pyetësori, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka kthyer përgjigje të pjesshme të tij në datën 21.12.2020, duke kërkuar kohë në lidhje me disa pyetje, ndër të cilat edhe për pyetjen nr. 5, që lidhet me burimin e blerjes së automjetit të dhënë në huapërdorje nga vëllai K. A.. Ndërkohë, në përgjigje të pyetjes nr. 7 që lidhet me të ardhurat nga sigurimi *kasko* për automjetin me targë {***}, rezulton se subjekti është përgjigjur se ky automjet është i njëjtë me automjetin me targë {***}, i blerë nga vëllai K. A., duke bërë sqarimet përkatëse në lidhje me ndryshimin e targës nga {***} në {***}, por pa dhënë informacionin e kërkuar nga Komisioni mbi burimin e të ardhurave të blerjes së tij. Në përgjigjet e tjera për të njëjtin pyetësor, dërguar në Komision nëpërmjet e-mail-it të datës 05.01.2021, subjekti i rivlerësimit ka vijuar të mos japë informacion lidhur me burimin e blerjes së automjetit, duke pretenduar se për sa u përket pyetjeve në lidhje me vëllain K. A., ende nuk kishin ardhur dokumentet e dërguara nga ai me anë të shërbimit postar. Në vijim, më datë 19.01.2021, subjekti i rivlerësimit ka dërguar përgjigjet e mbetura të pyetësorit nr. 3, me sqarimin se duke mos pasur përkthyes tjetër të gjuhës çeke, veç znj. A. H., është detyruar që përkthimin e akteve ta bëjë vetë vëllai K. A.. Në përgjigje të pyetjes nr. 5 të pyetësorit nr. 3, rezulton se subjekti ka deklaruar: *Automjeti me targë {***}, është blerë nga vëllai im në datën 28.09.2010, në shumën 17 mijë euro. Sa i përket burimit të të ardhurave të blerjes së automjetit, vëllai i ka marrë hua nga shtetasi Gj. A.. Ky i fundit e ka burimin e të ardhurave nga puna. Bashkëngjitur po ju dërgoj deklaratën*

³⁶ Kontrata nr. {***} rep., nr. {***} kol, datë 17.10.2011.

³⁷ Shkresa nr. {***}, datë 28.12.2020.

³⁸ Dërguar nga Komisioni më datë 14.12.2020, me afat përgjigje datën 21.12.2020.

noteriale të lëshuar nga z. Gj. A. dhe kopje të të ardhurave nga puna sipas formularëve P60, për periudhën prill 2008 - prill 2010. Përgjigja po jepet me vonesë, pasi i gjithë dokumentacioni justifikues më ka mbërritur me postë në datën 11.01.2021. Në vlerësimin e trupit gjykues, përgjigja me vonesë e subjektit të rivlerësimit për pyetëtorin nr. 3, ka qenë e pakushtëzuar nga dokumentacioni provues në lidhje me këtë burim, i cili mund të ishte depozituar më vonë në kohë sikurse edhe ka ndodhur.

108. Në prapësime ndaj rezultateve të hetimit, në lidhje me burimin e krijimit të pasurisë objekt kontrolli, subjektit të rivlerësimit ka pretenduar se: *Edhe me shpjegimet e mia të mëparshme, kam arritur të provoj se vëllai im e ka blerë automjetin me burime të ligjshme. Të hollat që janë përdorur për blerjen e këtij automjeti, janë të ardhura që rezultojnë nga paga dhe janë të taksuara, pavarësisht se janë marrë hua nga vëllai. Në këtë rast, Komisioni duhet që analizën e tij sa i përket huasë së marrë nga vëllai për blerjen e automjetit, ta kufizojë në dy drejtime: burimin e ligjshëm të të hollave të blerjes së autoveturës dhe mundësinë e huadhënësit për të dhënë hua shumë 17.000 euro. Nga analizimi i të ardhurave të huadhënësit, rezulton se ai ka pasur mundësi që për periudhën prill 2008 – prill 2010, të kursejë të holla pasi zbrësim shpenzimet jetike. Mosdokumentimi i datës së saktë të kthimit të huasë në këtë rast, si gjetje e Komisionit, nuk qëndron, pasi të dyja palët në marrëdhënien e huasë, përveçse kanë pranuar ekzistencën e huasë, kanë pranuar që ajo shumë është kthyer. Huaja është kthyer përsëri pas vitit 2018 në deklaratimet që më kanë dhënë. Për këtë moment kontrolli, vlerësoj se rëndësi ka burimi i ligjshëm i huasë dhe mundësia e dhënies së saj.*
109. Nëpërmjet deklaratës noteriale të datës 04.11.2020, përpara noterit publik Gj. A., deklaroi se në vitet 2009 dhe 2010 i ka dhënë shumë totale 15.000 GBP, pa interes, K. A.. Po ashtu, K. A., me anë të një deklaratë të datës 15.12.2020³⁹, deklaroi se ka marrë hua nga shtetasi Gj. A., shtetas në Britaninë e Madhe, shumë 15.000 GBP, pa interes, dhe se këtë shumë e ka shlyer plotësisht në vitet në vijim dhe, rrjedhimisht, detyrimet pushuan së ekzistuari. Trupi gjykues vlerëson se deklaratat e mësipërme, në kushtet kur janë hartuar gjatë procesit të rivlerësimit dhe nuk mbështeten nga ndonjë dokumentacion ligjor i kohës kur pretendohet se është krijuar marrëdhënia e huasë dhe nga përmbajtja e tyre rezulton se asnjëri prej deklaruesve nuk ka përcaktuar një datë për dhënien e huasë, vendin dhe mënyrën e dhënies së saj, si edhe as kohën, vendin dhe mënyrën e kthimit të kësaj huaje, ato u konsideruan pa vlerë provuese nga trupi gjykues.
110. Lidhur me pretendimin e subjektit se automjeti nuk është përdorur vetëm prej tij, trupi gjykues konstaton se, si të vetmen provë, subjekti ka paraqitur një deklaratë noteriale të babait dhe vëllait të tij⁴⁰, e cila vlerësohet nga trupi gjykues pa vlerë provuese për sa kohë pretendimi i subjektit nuk mbështetet nga prova të tjera.
111. Në vlerësim të trupit gjykues, bazuar në situatën faktike të analizuar më sipër, është i pajustificuar qëllimi i vëllait të subjektit të rivlerësimit K. A., i cili në vitin 2010 jetonte në Pragë, Çeki, për blerjen e automjetit në Shqipëri, në çmimin 17.000 euro. Nga hetimi administrativ i Komisionit

³⁹ Deklarata është e bërë në gjuhën çeke, ka vulën dhe nënshkrimin e një noteri.

⁴⁰ Deklarata noteriale B. dhe J. A. nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 06.05.2021.

lidhur me burimin financiar të të ardhurave për një hua në shumën 10.000 euro, që vëllai K. A. i dha subjektit të rivlerësimit po në vitin 2010 për qëllime studimi (sikurse është trajtuar më lart në këtë vendim), rezultoi se, në kohën e dhënies së huasë, vëllai K. A. nuk ishte i punësuar dhe si burim të vetëm të ardhurash kishte pagën e të fejuarës së tij O. R., pasi të ardhurat e tij kanë filluar pas muajit tetor 2010. Në vlerësimin e trupit gjykues, është e paarsyeshme dhe joproporcionale që në situatën financiare që kishte vëllai K. A., të merrte një hua të konsiderueshme, prej 17.000 eurosh, për blerjen e një automjeti në Shqipëri, të cilin nuk e përdori në vendbanimin e tij në Pragë, Çeki, por ia la në përdorim subjektit të rivlerësimit për shumë vite, i cili rezultoi të ishte përdoruesi i vetëm, pa ndërprerje i tij. Sikurse është analizuar më lart, mbeti e pabesueshme marrëdhënia e pretenduar e vëllait K. A. me kushëririn Gj. A. për marrjen e huasë 17.000 euro. Po ashtu, mbeti e paprovuar me dokumentacion ligjor mënyra e transferimit të kësaj shume te vëllai tjetër J. A., i cili lidhi kontratën e blerjes dhe pagoi çmimin e saj.

112. Në përfundim të kësaj analize, trupi gjykues arriti në përfundimin se, lidhur me pasurinë automjet i tipit “Mercedes Benz”, subjekti i rivlerësimit ka kryer fshehje të pasurisë, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “c” e ligjit nr. 84/2016.
113. Lidhur me vlerësimin e Komisionit se *veprimet e subjektit të rivlerësimit përbëjnë zgjedhje të cilat jo vetëm nuk shërbejnë në krijimin e besimit të publikut te drejtësia, por e dëmtojnë atë, në kuptim të parashikimeve të pikës 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016*, trupi gjykues vlerëson se ndërkohë që situata faktike lidhur me automjetin është kualifikuar si fshehje e pasurisë dhe Komisioni e ka bazuar dhënien e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, aplikimi për të njëjtën situatë faktike edhe i parashikimit të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 është i panevojshëm dhe i gabuar.
- Mbi shkakun e ankimit që lidhet me pasuritë e llojit “garazh”, sistem kondicionimi dhe gjendje *cash* në banesë:
114. Subjekti i rivlerësimit kundërshton në ankim vlerësimin e Komisionit lidhur me 2 garazhe të blera nga subjekti i rivlerësimit në vitin 2017, sistemin e kondicionimit të apartamentit të banimit dhe një gjendje *cash* në banesë se: *subjekti ka bërë deklaram të pasaktë e të pamjaftueshëm në kuptim të parashikimeve të pikave 1, 3 dhe 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe germës “b” të pikës 5 të nenit 33 dhe pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.*
115. Subjekti i rivlerësimit e bazon këtë shkak të ankimit në pretendimet se ka pasur mundësi të justifikojë me burime financiare të ligjshme, pasuritë dhe shpenzimet e evidentuara më sipër, pasi, sipas një analize financiare të prezantuar në përmbajtjen e ankimit, rezulton se gjendja e likuiditeteve në banesë në datën 31.12.2016, ka qenë në vlerën 4.046.018 lekë dhe jo në vlerën e përlloritur nga Komisioni, prej 1.145.109 lekësh. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit kundërshton si të gabuar analizën financiare të Komisionit për periudhën 01.01.2017 - 28.01.2017, duke paraqitur në përmbajtje të ankimit një analizë financiare për të njëjtën periudhë, sipas së cilës rezultati del pozitiv në ndryshim nga rezultati negativ i Komisionit prej (-) 3.084.794 lekësh.

116. Trupi gjykues, lidhur me këtë shkak ankimi, pasi shqyrtoi aktet e fashikullit të Komisionit, konstatoi dhe vlerësoi si më poshtë.
117. Në deklaratën *vetting*, subjekti ka deklaruar: *Blerje garazhi (dy copë), ndodhur në Rrugën e {***}, pallati {***}. Me kontratën e shitjes nr. {***}, datë 27.01.2017, redaktuar para noteres M. S., Tiranë. Vlera 10.000 euro. Pjesa takuese 50%. Burimi i krijimit: kursimet.*
118. Në deklaratën *vetting*, subjekti ka deklaruar: *Sistem kondicionimi për apartamentin në Rrugën e {***}, pallati {***}, Shkalla {***}, Objekti {***}, Apartamenti {***}, Kati {***}, Tiranë. Fatura tatimore nr. {***}, datë 27.01.2017, nga {***} ShPK, Tiranë. Vlera 1.367.800 lekë. Pjesa takuese 100%. Burimi: kursimet.*
119. Në deklaratën *vetting*, subjekti ka deklaruar: *Gjendje cash në shtëpi në vlerën 1.500.000 lekë. Burimi i krijimit: mbetur nga kursimet nga paga.*
120. Rezulton se më datë 27.01.2017, subjekti i ka paguar palës shitëse nëpërmjet Bankës Tirana, shumën 10.000 euro për blerjen e 2 garazheve sipas kontratës së shitjes me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 27.01.2017. Gjatë hetimit administrativ, subjekti ka deklaruar se pagesa e vlerës 1.367.800 lekë, për sistemin e kondicionimit të apartamentit të banimit të ndodhur në Rrugën e {***}, Tiranë, është kryer *cash* më datë 27.01.2017, në ambientet e shitësit, dhe ka depozituar faturën tatimore nr. {***}, datë 27.01.2017, si dhe mandatarkëtimin nr. {***}, datë 27.01.2017.
121. Komisioni ka kryer analizën e burimit të të ardhurave të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit për blerjen e dy garazheve, investimin për sistemin e kondicionimit, si dhe krijimin e likuiditeteve, gjendjes *cash* të deklaruar në deklaratën *vetting*, duke konstatuar se subjekti deri në datën 31.12.2015, nuk ka pasur mundësi financiare të akumulojë likuiditete *cash* në banesë në formën e kursimeve. Në DIPP-2016, subjekti ka deklaruar: *Shtuar kursimet e ruajtura në shtëpi nga të ardhurat nga paga në vlerën 1.200.000 lekë. Lidhur me kursimet e deklaruara në vitin 2016, Komisioni ka konstatuar se subjekti ka mungesë të burimeve financiare në vlerën 54.891 lekë, duke vlerësuar si kursim me burim të ligjshëm në vitin 2016, shumën 1.145.109 lekë (1.200.000 lekë - 54.891 lekë). Në këto kushte, Komisioni verifikoi nëse subjekti i rivlerësimit mund t'i krijonte pasuritë dhe investimet me të ardhurat e realizuara gjatë periudhës 01.01.2017 - 28.01.2017 dhe, nga analiza financiare, i ka rezultuar një pamundësi financiare në shumën (-) 3.084.794 lekë.*
122. Trupi gjykues i Kolegjit, nëpërmjet Njësisë së Shërbimit Ligjor, kontrollloi fillimisht analizën e kryer nga Komisioni në lidhje me likuiditetet gjendje *cash* në vitin 2016, i cili konfirmoi rezultatin e Komisionit se gjendja *cash* me burime financiare të ligjshme më datë 31.12.2016, ishte në shumën 1.145.109 lekë. Po ashtu, nga analiza financiare e kryer në funksion të kontrollit të burimeve financiare për blerjen e apartamentit të banimit në Tiranë (trajtuar më lart në këtë vendim), ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit nuk kishte mundësi, më 31.12.2015, të dispononte kursime gjendje *cash* të krijuara me burime financiare të ligjshme. Sa më sipër, pretendimi i subjektit të rivlerësimit se gjendja e likuiditeteve *cash* në banesë, në datën 31.12.2016, ka qenë në shumën 4.046.019 lekë, vlerësohet nga trupi gjykues i pabazuar. Në vijim të kontrollit të analizës financiare

të Komisionit, për periudhën 01.01.2017 - 28.01.2017, trupi gjykues konstatoi se konfirmohet rezultati i Komisionit se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime financiare të ligjshme, për të justifikuar krijimin e këtyre pasurive dhe kryerjen e investimeve në shumën 3.084.794 lekë.

123. Në përfundim të analizës për këtë shkak ankimi, trupi gjykues e gjen të bazuar vlerësimin e Komisionit se për dy pasuritë e llojit “garazh”, ndodhur në Rrugën e {***}, Tiranë, investimin për sistemin e kondicionimit të apartamentit të banimit dhe likuiditetet gjendje *cash* në shumën 1.500.000 lekë, subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

➤ Lidhur me pasurinë automjet “Mitsubishi”:

124. Subjekti kundërshton vlerësimin e Komisionit se *shpjegimet në lidhje me çmimin e blerjes së kësaj pasurie, mundësia financiare e shtetasit A. Z., mospërdorimi nga pronari legal i tij për shkak të qëndrimit në Angli, si dhe përdorimi i këtij automjeti nga subjekti i rivlerësimit disa ditë pas zhdoganimit, bëjnë që Komisioni të arrijë në konkluzionin se nga subjekti i rivlerësimit, është kryer fshehje e kësaj pasurie në kuptim të parashikimeve të pikave 1, 3 dhe 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe germës “c” të pikës 5 të nenit 33, si dhe pikave 3 dhe 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.*

125. Komisioni e ka bazuar vlerësimin e kësaj pasurie në konstatimet se: (i) ky automjet ka qenë në përdorim të subjektit të rivlerësimit disa ditë pas zhdoganimit dhe regjistrimit të tij, dhe nuk rezulton të jetë përdorur nga pronari i tij për shkak të qëndrimit në Angli; (ii) subjekti i rivlerësimit e ka blerë automjetin nga shitësi A. Z. në datën 12.08.2014, megjithëse rezulton se ai më parë i ishte shitur shtetasit J. Ç. në datën 02.04.2010; (iii) nuk justifikohet si logjikisht, ashtu edhe financiarisht shpenzimi i kryer nga shtetasi A. Z. për blerjen e automjetit në Angli me të ardhurat nga puna si emigrant, të cilin nuk e përdor, por ia jep në përdorim subjektit të rivlerësimit disa ditë pas zhdoganimit dhe pa kundërshtpërbllim.

126. Subjekti e kundërshton këtë vlerësim të Komisionit, duke pretenduar se: (i) e ka përdorur këtë automjet vetëm për udhëtimet jashtë shtetit deri më 17.03.2010; (ii) bazuar në parashikimet e ligjit nr. 9049/2003, subjektet deklaruese nuk kanë pasur detyrim deklarimin e pasurive të luajtshme në përdorim në atë kohë dhe mosdeklarimi i përdorimit të këtij automjeti në deklaratimet periodike vjetore, nuk duhet të konsiderohet shkelje; (iii) automjeti ka qëndruar te të afërmit e A. Z. dhe në vitin 2014, duke qenë se automjeti nuk ishte përdorur, i ka kërkuar këtij të fundit që ta blejë atë dhe, më datë 12.08.2014, është realizuar shitja; (iv) subjekti i rivlerësimit nuk kishte pengesë të blinte automjetin në vitin 2014, pasi kontrata e shitjes e vitit 2010 nuk ka dhënë asnjë efekt pasi nuk është paguar çmimi i saj dhe, në këto kushte, pronari i sendit nuk ka pasur asnjë pengesë për ta tjetërsuar atë; (v) ka arritur të provojë bindshëm mundësitë financiare të blerësit A. Z., pasi, sipas dokumentacionit tatimor të depozituar në Komision, të ardhurat nga pagat e tij, për periudhën prill 2008 - prill 2009, janë në vlerën 22.301 GBD, të cilat justifikojnë blerjen e automjetit dhe pagesën e detyrimeve doganore; (vi) Komisioni, duke keqpërdorur mjetin e “barrës së provës”, i ka ngarkuar atij veprime dhe përfundime të cilat nuk janë rrjedhojë e një hetimi objektiv e të paanshëm; (vii)

çmimi i blerjes së automjetit është normal, duke marrë parasysh gjendjen e automjetit, si dhe faktin e mospërdorimit të tij për një kohë të gjatë dhe nuk ka qenë i ndikuar nga ndonjë gjendje konflikti interesi apo faktor tjetër.

127. Trupi gjykues, lidhur me këtë shkak ankimi, pasi shqyrtoi aktet e fashikullit të Komisionit, konstaton dhe vlerëson si më poshtë.
128. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën *vetting*: *Blerje autoveturë gjahu Mitsubishi, prodhim anglez, viti 1999. Blerë me kontratën nr. {***}, datë 12.8.2014, te noteri B. A., Gjirokastër, vlera 200.000 lekë, burimi të ardhurat nga paga. Po ashtu, subjekti ka deklaruar: Përdorimi pa pagesë i autoveturës në pronësi të shtetasit A.Z., me targë {***}, për periudhën 2009-2010. Kontratë nr. {***}, datë 16.02.2009, para noter B. A., Gjirokastër.*
129. Në DIPP-2014, në rubrikën e ndryshimit të pasurive dhe burimit të krijimit, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Blerje automjet gjahu "Mitsubishi Shogun", me kontratë, në datën 12.8.2014, në Gjirokastër, në shumën 200.000 lekë.*
130. Referuar të dhënave nga DSHPTRR-ja, ka rezultuar se automjeti është marrë në datën 13.1.2009, në Angli, nga shtetasi A. Z., si dhe është zhdoganuar me DAV, nr. {***}, datë 9.2.2009, duke shlyer detyrimet doganore në shumën 332.284 lekë. Certifikata e pronësisë së këtij automjeti është lëshuar nga DRSHTRR-ja Gjirokastër në datën 11.2.2009, në emër të A. Z..
131. Sipas kontratës së huapërdorjes nr. {***}, datë 16.2.2009, shtetasi A. Z. i ka dhënë në përdorim subjektit automjetin tip "Mitsubishi Shogun", vit prodhimi 1999, me targë {***}⁴¹, për një periudhë 3-vjeçare, me kusht që në rast se huadhënësi i kërkon automjetin huamarrësit, në çdo kohë, afati quhet i mbaruar.
132. Në vitin 2014, subjekti i rivlerësimit rezulton të ketë blerë nëpërmjet kontratës nr. {***}, datë 12.8.2014, nga shtetasi A. Z. automjetin objekt shqyrtimi kundrejt çmimit 200.000 lekë, i cili, sipas kontratës së shitjes, deklarohet i likuiduar jashtë zyrës noteriale.
133. Në DIPP-2016, në rubrikën për ndryshimin e pasurive dhe burimin e krijimit, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *shitje automjet gjahu "Mitsubishi Shogun", me kontratë në datë 17.10.2016, në shumën 200.000 lekë.* Sipas kësaj kontrate, rezulton se subjekti ia ka shitur këtë automjet shtetasit D. M., kundrejt çmimit 200.000 lekë, i cili deklarohet i likuiduar jashtë zyrës noteriale.
134. Gjatë hetimit administrativ, subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit nr. 3, ka deklaruar se: *Sa i përket përdorimit të automjetit, veç përdorimit nga pronari, rezulton se është përdorur edhe nga të afërmit e tij, si dhe nga një person juridik privat. Bashkëngjitur po ju dërgoj deklaratat noteriale.* Referuar dokumentacionit bashkëlidhur përgjigjeve për këtë pyetësor, subjekti ka dorëzuar, ndër të tjera, edhe një vërtetim të datës 22.12.2020, të noterit B. A., i cili vërteton se: *në*

⁴¹ Më datë 15.08.2014, ka ndryshuar targa e mjetit nga {***} në {***}, për t'u ndryshuar përsëri për shkak të humbjes më datë 16.02.2016, në {***}.

këtë datë është paraqitur shtetasi J. Ç., i cili ka kërkuar nga arkivi noterial dhe të vërtetohet njësia me origjinalin e kontratës së shitjes së automjetit nr. {***}, datë 02.04.2010, ku J. Ç. është në cilësinë e “palës blerëse“, ndërsa A. S. Z. është në cilësinë e “palës shitëse” të një automjeti me këto karakteristika: Mitsubishi Shogun, vit prodhimi 1999, ngjyra blu, me targë {***}. Noteri deklaron se, nuk e disponon këtë kontratë, pasi ka kaluar afati ligjor i ruajtjes prej 10 vitesh në arkiv, si dhe ka fotokopjuar fq.27 të Regjistrimit të Përgjithshëm të Akteve dhe Veprimeve Noteriale, ku pasqyrohet një kontratë shitje me të dhënat e sipërcituara.

135. Në përgjigjet shtesë të pyetësorit nr. 3, dërguar Komisionit më datë 19.01.2021, subjekti ka deklaruar se: *Sa i përket vlerës së blerjes së automjetit, shtetasi A. Z. nuk ka mundësi objektive të gjejë dokumentin justifikues të vlerës së tij, për shkak të kalimit të kohës së gjatë. Më ka deklaruar se vlera mund të ketë qenë rreth 2.000 paund, por jo me siguri të plotë. Në lidhje me burimin e të ardhurave, subjekti ka deklaruar: Sa i takon burimit të të ardhurave, automjeti është blerë me të ardhurat nga puna. Bashkëngjitur po ju paraqes formularin e të ardhurave vjetore nga puna (prill 2008 - prill 2009). Referuar këtyre formularëve, të ardhurat për vitin tatimor deri në 5 prill 2009, janë në vlerë 22.301 GBP, dhe taksa e reduktuar është 2.364 GBP.*
136. Komisioni ka konstatuar se çmimi i blerjes i pretenduar nga subjekti i rivlerësimit për blerjen e këtij automjeti në Angli rreth 2000 GBP, nuk përputhet me deklarin e bërë nga A. Z. në doganë në datën 9.2.2009, pasi, referuar dokumentacionit të zhdoganimit të automjetit, çmimi i tij është deklaruar në vlerën 1 euro dhe prej tij është paguar detyrimi doganor prej 332.284 lekësh, ndërsa mbeti e paprovuar vlera reale e blerjes së automjetit.
137. Pavarësisht se në pamje të parë duket se shtetasi A. Z. ka pasur mundësi financiare për blerjen e këtij automjeti në vitin 2009, trupi gjykues nuk e gjen të justifikuar arsyen se përse me të ardhurat e përfituara nga puna e tij në emigracion, ai duhej të investonte në blerjen e një automjeti, i cili do të vihej në përdorim të subjektit të rivlerësimit pa kundërshtim me një afat të gjatë 3-vjeçar, menjëherë pas sjelljes së tij në Shqipëri dhe që, rreth pesë vite më vonë, iu shit subjektit në një vlerë ndjeshëm më të ulët se ajo e blerjes dhe e zhdoganimit.
138. Rezultoi e provuar se vetëm disa ditë pas zhdoganimit të automjetit, pronari i tij ia ka lënë atë në huapërdorje subjektit dhe nuk u provua në asnjë formë përdorimi i këtij mjeti nga vetë pronari apo nga shtetas tjerë. Deklaratat noteriale të paraqitura nga subjekti gjatë procesit në Komision, në mbështetje të pretendimeve të tij lidhur me përdorimin e këtij automjeti, si akte të hartuara gjatë procesit të rivlerësimit, konsiderohen me vlerë të kufizuar provuese për sa ato synohet të provojnë. Në vlerësimin e trupit gjykues, pretendimet e subjektit të rivlerësimit lidhur me përdorimin e këtij automjeti edhe nga persona të tjerë, janë të paqarta referuar shpjegimeve dhe provave të paraqitura prej tij në lidhje me veprimet noteriale të kryera për tjetërsimin e kësaj pasurie. Paraqitja nga subjekti i rivlerësimit i vërtetimit të noterit për kontratën e shitjes së automjetit në vitin 2010, si dhe deklaratës noteriale të shtetasit J. Ç., ku pretendohet se e ka blerë dhe përdorur automjetin për llogari të një shoqërie tregtare, nuk provojnë faktet e pretenduara.

139. Ndërkohë, trupi gjykues vëren se Komisioni nuk ka mbajtur në konsideratë faktin se kjo pasuri nuk ishte në pronësi të subjektit të rivlerësimit në momentin e dorëzimit të deklaratës *vetting*, për shkak të shitjes së saj në vitin 2016. Sa më sipër, duke qenë se në momentin e dorëzimit të deklaratës *vetting*, rezulton se kjo pasuri nuk ka qenë në pronësi të subjektit, trupi gjykues vlerëson se gjetjet e Komisionit për këtë pasuri, nuk duhen të kualifikohen sipas nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016.
140. Pavarësisht këtij konkluzioni, bazuar në situatën faktike të analizuar më sipër, sipas së cilës rezultoi se: (i) subjekti i rivlerësimit e ka pasur në përdorim këtë automjet me një kontratë përdorimi me afat 3-vjeçar, të lidhur në datën 16.02.2009, disa ditë pasi ky automjet kishte hyrë në Shqipëri; (ii) nga provat e administruara nuk rezulton që ky automjet të jetë përdorur nga persona të tjerë dhe në kushtet kur nuk justifikohet si logjikisht, ashtu edhe financiarisht shpenzimi i kryer nga shtetasi A. Z. për blerjen e automjetit në Angli me të ardhurat nga puna si emigrant, për t’ia dhënë menjëherë në përdorim pas blerjes subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vlerëson se për pasurinë automjet i tipit “Mitsubishi Shogun”, subjekti i rivlerësimit ka kryer fshehje të pasurisë, gjatë periudhës 2009 – 2014, fakt i cili mbahet parasysh nga trupi gjykues në vlerësimin tërësor të besueshmërisë së subjektit për kriterin e vlerësimit të pasurisë, në kuptim të nenit 59, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016.
141. Lidhur me kualifikimin e Komisionit të situatës faktike të analizuar më sipër, si cenim të besimit të publikut të sistemi i drejtësisë, trupi gjykues vlerëson se ndërkohë që situata faktike lidhur me automjetin është kualifikuar si fshehje e pasurisë në vitet 2009 - 2014 dhe Komisioni e ka bazuar dhënien e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit në nenin 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, aplikimi për të njëjtën situatë faktike edhe i parashikimit të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 është i panevojshëm dhe i gabuar.
- Në lidhje me pasuritë e padeklaruara, të përfituara me ligjin nr. 7501/1991 “Për tokën”:
142. Subjekti i rivlerësimit kundërshton vlerësimin e Komisionit se *subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e bashkëpronarit, me pjesë takuese ideale të këtyre pasurive, ka kryer deklaram të pasaktë pasi nuk i ka deklaruar këto pasuri.*
143. Këtë vlerësim, Komisioni e ka bërë bazuar në konstatimin se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar në deklaratën *vetting* faktin se është bashkëpronar me 1/6 pjesë takuese mbi pasuritë e paluajtshme të ndodhura në fshatin Damës, Njësia Administrative Fratar, Mallakastër: (i) tokë “arë” me sipërfaqe 1800 m²; (ii) “pemëtore” me sipërfaqe 301 m²; (iii) tokë “arë” me sipërfaqe 866 m²; “ndërtesë” me sipërfaqe totale 106,26 m². Këto toka bujqësore janë përfituar në pronësi nga familja e subjektit të rivlerësimit në bazë të ligjit nr. 7501/1991 “Për tokën”.
144. Subjekti i rivlerësimit e ka kundërshtuar këtë vlerësim të Komisionit, me pretendimin se ai nuk është bashkëpronar i këtyre pasurive të paluajtshme pasi me deklaratën noteriale nr. {***}, datë 16.5.2002, ka hequr dorë nga pronësia mbi këto pasuri dhe, si pasojë, ka humbur pronësinë bazuar në nenin 193 të Kodit Civil.

145. Trupi gjykues, bazuar në aktet e fashikullit të Komisionit, konstaton se, sipas informacionit të përcjellë nga ASHK-ja, Drejtoria Vendore Fier, zyra Mallakastër⁴², subjekti i rivlerësimit rezulton të jetë bashkëpronar me 1/6 pjesë takuese mbi këto pasuri. Subjekti nuk i ka deklaruar ndonjëherë këto pasuri si në deklaratat periodike vjetore, ashtu dhe në deklaratën *vetting*.
146. Bazuar në situatën e mësipërme faktike, trupi gjykues vlerëson se lidhur me pasuritë e cituara më sipër, subjekti i rivlerësimit kishte detyrimin ta bazonte deklarin e tij në deklaratën *vetting*, në përputhje me informacionin e regjistrave publikë të pasurive të paluajtshme, në të cilët ai rezultonte të ishte bashkëpronar në kohën e plotësimit të deklaratës, pavarësisht nga pretendimi se ai kishte hequr dorë nga pronësia mbi këto pasuri. Në këto kushte, trupi gjykues e gjen të drejtë konkluzionin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarin të pasaktë në deklaratën *vetting* për këto pasuri, duke u gjendur në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, por bazuar në faktin se këto pasuri janë fituar për shkak të ligjit, kjo situatë çmohet pa ndikim në vlerësimin e kriterit të pasurisë.
147. Gjithashtu, trupi gjykues vlerëson pa ndikim në vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, konstatimin e Komisionit se ai ka kryer deklarin të pasaktë për shkak se nuk ka deklaruar aktivitetin si person fizik të bashkëshortes J. A. në vitet 2013 dhe 2014.
- Në lidhje me konfliktin e interesave në ushtrimin e detyrës:
148. Subjekti i rivlerësimit kundërshton vlerësimin e Komisionit lidhur me veprimet e subjektit të rivlerësimit për çështjen nr. {***}, me datë regjistrimi 04.10.2019, të Gjykatës së Apelit Durrës, se: *veprimet e subjektit të rivlerësimit përbëjnë zgjedhje, të cilat nuk shërbejnë në krijimin e besimit të publikut te drejtësia.*
149. Këtë vlerësim, Komisioni e ka bazuar në konstatimin se nga verifikimi gjatë hetimit administrativ për çështje të shqyrtuara nga subjekti i rivlerësimit me palë ndërgjyqëse personat e tjerë të lidhur, shoqëritë tregtare në të cilat ata kanë qenë në cilësinë e ortakut/administratorit, ka rezultuar se në faqen zyrtare *online* të Gjykatës së Apelit Durrës, ku subjekti i rivlerësimit ushtronte funksionin e kryetarit, në datën 7.12.2020, u identifikua çështja gjyqësore nr. {***}, regjistruar më datë 04.10.2019, me palë shoqërinë përmbarimore private “{***}” ShPK, me NIPT {***}, ku në rubrikën detajet e çështjes, rezultonte gjyqtar subjekti i rivlerësimit dhe statusi i çështjes në “përpunim”.
150. Ky vlerësim i Komisionit është kundërshtuar nga subjekti i rivlerësimit, i cili ka pretenduar se: (i) ai nuk ka bërë asnjë veprim procedural për gjykimin e kësaj çështjeje, pasi ajo, pas rishortimit, është gjykuar nga gjyqtarë të tjerë; (ii) marrëdhënia e huamarries me shtetasin A. K. ka përfunduar në datën 28.04.2017, me kthimin e huasë nëpërmjet një kredie të marrë ne bankë; (iii) në vitin 2019, ortaku i vetëm i shoqërisë përmbarimore private “{***}” ShPK, A. K., ka shitur 100% të kuotave duke mos qenë më ortak dhe administrator i saj. Sipas subjektit, situata faktike e pretenduar nuk mund të trajtohet sipas parashikimeve të nenit 13 të ligjit nr. 9367/2005 dhe as sipas parashikimeve

⁴² Shkresa nr. {***}, datë 02.06.2020.

të nenit 72 të Kodit të Procedurës Civile. Po ashtu, ai ka pretenduar se pasqyrimi i të dhënave për çështjet në faqen zyrtare *online* të gjykatës menaxhohej nga persona të kontraktuar nga KLGj-ja dhe nuk varej nga gjyqtari i çështjes. Pavarësisht se çështja në fjalë ka rezultuar në emër të tij deri me datë 07.12.2020, në fakt më datë 17.11.2020 ajo i kishte kaluar për gjykim me short elektronik dhe fizikisht gjyqtarit F. K. dhe se pasqyrimi i këtyre të dhënave në sistem është bërë nga mirëmbajtësit e kontraktuar të faqes vetëm më datë 15.01.2021.

151. Lidhur me këtë shkak ankimi, trupi gjykues, pas shqyrtimit të akteve të çështjes, konstatoi se Komisioni nuk ka identifikuar dhe analizuar kryerjen e ndonjë veprimi konkret procedural për gjykimin e kësaj çështjeje nga subjekti i rivlerësimit, por është mjaftuar vetëm me analizimin e informacionit të siguruar nga faqja *online* e gjykatës. Në këto kushte, trupi gjykues e gjen të drejtë pretendimin e subjektit të rivlerësimit se me veprimet e tij për këtë çështje, ai nuk ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, në kuptim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

➤ Lidhur me cenimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë:

152. Subjekti i rivlerësimit ka kundërshtuar vlerësimin e Komisionit se: *në kuptim të parashikimeve të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te drejtësia pasi veprimet e subjektit të rivlerësimit, referuar sa analizuar në pikat 2, 4 dhe 7 të këtij vendimi, përbëjnë zgjedhje të cilat nuk shërbejnë në krijimin e besimit të publikut te drejtësia*. Këtë vlerësim, Komisioni e ka bazuar në konkluzionet për fshehjen nga subjekti i rivlerësimit të pasurisë automjet “Mercedes Benz”, fshehjen e pasurisë automjet “Mitsubishi” dhe cenimin e parimit të paanësisë lidhur me një çështje gjyqësore.

153. Trupi gjykues, lidhur me këtë shkak ankimi, duke u bazuar në vlerësimin e bërë më sipër në këtë vendim për shkaqet e ankimit që lidheshin me automjetet dhe një çështje gjyqësore, arrin në konkluzionin se kualifikimi nga Komisioni i situatave faktike të provuara sipas nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, është i gabuar në kushtet kur problematikat lidhur me dy automjetet janë kualifikuar sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, kurse për çështjen gjyqësore nuk rezultoi ndonjë problematikë.

154. Në përfundim të shqyrtimit të kësaj çështjeje, bazuar në konkluzionet e mësipërme, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë, duke u gjendur në kushtet e nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Për pasojë, vendimi nr. 391, datë 26.05.2021, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit është i mbështetur në fakte e në ligj dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në nenin 66, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

- Lënien në fuqi të vendimit nr. 391, datë 26.05.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Desart Avdulaj.
- Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 17.12.2024.

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

RELATOR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

KRYESUESE

Ina RAMA

nënshkrimi